



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 50, datë 6.10.2021

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR DEBITIMIN DIREKT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 21 dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 129 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 15, pika 1, të ligjit nr.133, datë 30.4.2013, “Për sistemin e pagesave”; si dhe Titullit III dhe IV të ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020, “Për shërbimet e pagesave”; me propozimin e Departamentit të Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për debitimin direkt”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Sistemeve të Pagesave, Kontabilitetit dhe Financës dhe Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, si dhe të gjithë subjektet e përcaktuar si ofrues të shërbimeve të pagesave sipas nenit 3, pika 2, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës nr. 148, datë 20.11.1998, "Për sistemin dhe instrumentet e pagesave".
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI

KRYETARI

Elvis ÇIBUKU

Gent SEJKO

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat për përdorimin e instrumentit të debitimit direkt si shërbim pagese për konsumatorët dhe mikrondërmarrjet.
2. Përcaktimet në këtë rregullore i referohen aplikimit të instrumentit të debitimit direkt, në kuadër të klerimit të instruksioneve përkatëse të pagesave në sistemin AECH, por edhe rastit kur klerimi kryhet brenda vetë OSHP (kur debitori dhe kreditori kanë llogaritë në të njëjtën OSHP).

Neni 2

Baza juridike

Zbatimi i kësaj rregulloreje duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e akteve të mëposhtme:

- a) Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
- b) ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”;
- c) ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”;
- d) ligjit “Për sistemin e pagesave”;
- e) ligjit “Për shërbimet e pagesave”;
- f) ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”;
- g) rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për funksionimin e sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe – AIPS”;
- h) rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për funksionimin e sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH”;
- i) rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për shërbimin e debitimit direkt për konsumatorët dhe mikrondërmarrjet.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave, si në rastin kur janë pjesëmarrës në sistemin AECH, ashtu edhe kur nuk janë pjesëmarrës në të, të cilët zgjedhin të ofrojnë instrumentin e debitimit direkt si shërbim pagese për konsumatorët dhe mikrondërmarrjet, si dhe nga Banka e Shqipërisë, e cila është operator i sistemit AECH.

Neni 4

Përkufizime

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore, të gjitha përkufizimet e parashikuara në ligjin “Për shërbimet e pagesave”, rregulloret e sistemit AIPS dhe rregulloret e sistemit AECH, vlejnë edhe për këtë rregullore. Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **Data e debitimi** – është data në të cilën debitohet llogaria e debitorit;
2. **Data e detyrimit** – është data në të cilën debitori i detyrohet për pagesë kreditorit. Kjo datë vendoset nga debitori dhe kreditori në marrëveshjen midis tyre;

3. **Data e shlyerjes** – është data në të cilën ekzekutohet shlyerja në sistemin AIPS e rezultatit të klerimit të debitimit direkt në AECH, dhe/ose lëvizja e fondeve midis llogarive përkatëse të debitorit dhe kreditorit;
4. **Debitor** – është personi pagues, të cilit i debitohet llogaria e pagesës që mban me OSHP-ja e tij, për shumën e përcaktuar në kërkesën për arkëtim. Debitori është edhe lëshuesi i mandatit;
5. **Debitim direkt (DD)** – është një shërbim pagese për debitimin e llogarisë së pagesës së paguesit, ku një transaksion pagese inicohet nga përfituesi i pagesës, në bazë të pëlqimit që paguesi i ka dhënë përfituesit të pagesës, ofruesit të shërbimit të pagesave të përfituesit të pagesës ose ofruesit të shërbimit të pagesave të vetë paguesit;
6. **Dematerializim i mandatit** – është konvertimi në të dhëna elektronike i informacionit të mandatit në formë letër;
7. **Ditë kalendarike** – është çdo ditë e vitit. Kudo ku në këtë rregullore përdoret termi “ditë” pa e shoqëruar me fjalën “pune” apo “kalendarike”, nënkuptohet “ditë kalendarike”;
8. **Ditë pune** – është dita në të cilën ofruesi përkatës i shërbimit të pagesave të paguesit ose ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit të pagesës, të përfshirë në ekzekutimin e një transaksioni pagese, është në punë, me qëllim ekzekutimin e një transaksioni pagese;
9. **Ditë pune ndërbankare** – është dita në të cilën janë të hapur për operim sistemet e pagesave në Bankën e Shqipërisë;
10. **ID-ja e kreditorit** – është një kod i cili i caktohet në mënyrë të vetme një kreditori dhe që përdoret për identifikimin e këtij të fundit si origjinues instruksionesh të debitimit direkt. Një kreditor mund të përdorë disa ID. ID-ja e kreditorit caktohet nga Banka e Shqipërisë;
11. **Kërkesë për arkëtim** – nënkupton një pjesë të një transaksioni debitimi direkt, duke filluar nga inicimi i tij nga përfituesi deri në përfundimin e tij përmes debitimit normal të llogarisë së pagesës së paguesit;
12. **Kreditor** – është personi përfitues i pagesës, të cilit i kreditohet llogaria e pagesës që mban me OSHP-në e tij, për shumën e përcaktuar në kërkesën për arkëtim;
13. **Mandat i debitimit direkt (Mandati)** – është shprehja e pëlqimit dhe autorizimit të dhënë nga paguesi ndaj përfituesit dhe (direkt ose indirekt përmes përfituesit) ndaj OSHP-së të paguesit, për të lejuar përfituesin të iniciojë një kërkesë për arkëtim me anë të debitimit të llogarisë së pagesës të përcaktuar të paguesit dhe për t’i lejuar OSHP-së së paguesit të veprojë në pajtim me një udhëzim të tillë;
14. **“Njih Klientin Tënd” (KYC = “Know Your Customer”)** – nënkupton tërësinë e standardeve të përdorura në industrinë e investimeve dhe shërbimeve financiare për verifikimin e klientëve, si dhe profileve të tyre financiare e të rrezikut. Në kuadër të kësaj rregulloreje, do të nënkuptojë edhe detyrimin që kanë OSHP-të në lidhje me zbatimin e parimeve të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, sipas përcaktimeve në legjisllacionin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe legjisllacionit lidhur me shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare;
15. **Ofrues i shërbimeve të pagesave (OSHP)** – është një nga subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 2, të ligjit “Për shërbimet e pagesave”, ose një

- person fizik tregtar ose juridik që ofron shërbime pagesash dhe që përfiton nga përjashtimet sipas neneve 27 ose 28 të ligjit;
16. **OSHP-ja i debitorit** – është OSHP-ja me të cilin debitori ka hapur llogari pagese, e cila do të debitohet për shumën e përcaktuar në transaksionin e debitimit direkt. OSHP-ja i debitorit mund të jetë pjesëmarrës në sistemin AECH, si edhe ndërmjetësues për OSHP të tjerë, por në kuptimin e përgjithshëm të përdorur në këtë rregullore kufizohet në veprimtarinë që ofron për debitorin;
 17. **OSHP-ja i kreditorit** – është OSHP-ja me të cilin kreditori ka hapur llogari pagese, e cila do të kreditohet për shumën e përcaktuar në transaksionin e debitimit direkt. OSHP-ja i kreditorit mund të jetë pjesëmarrës në sistemin AECH, si edhe ndërmjetësues për OSHP të tjerë, por në kuptimin e përgjithshëm të përdorur në këtë rregullore kufizohet në veprimtarinë që ofron për kreditorin;
 18. **OSHP-ja ndërmjetësues** – është term i përdorur për të cilësuar një pjesëmarrës në sistemin AECH, i cili nëpërmjet asaj pjesëmarrjeje u mundëson klerimin e instruksioneve të debitimit direkt OSHP-ve të tjerë jo pjesëmarrës në AECH, të cilët, nëpërmjet këtij ndërmjetësimi, e ofrojnë shërbimin e debitimit direkt për klientët e tyre;
 19. **Palë referencë** – është një person fizik ose juridik në emër të të cilit një pagues bën një pagesë ose një përfitues merr një pagesë;
 20. **Përdorues i shërbimeve të pagesave (PSHP)** – është personi fizik ose juridik i cili përdor shërbimet e pagesave në cilësinë e paguesit, të përfituesit të pagesës, ose të të dyjave;
 21. **Pjesëmarrës** – janë Banka e Shqipërisë dhe subjektet e tjera ofruese të shërbimeve të pagesave, që janë pranuar të marrin pjesë në sistemin AECH, statusi si pjesëmarrës i të cilëve nuk është pezulluar apo anuluar;
 22. **Referenca unike e mandatit** – është një referencë, e cila, për një kreditor, identifikon në mënyrë të vetme një mandat debitimi direkt të nënshkruar nga një debitor për atë kreditor;
 23. **Sistemi AECH (Automated Electronic Clearing House)** – është sistemi elektronik i klerimit të instruksioneve të pagesave në lekë me vlerë të vogël brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, që mundëson:
 - i. shkëmbimin e fileve të instruksioneve të pagesave midis pjesëmarrësve,
 - ii. llogaritjen e pozicioneve shumëpalëshe neto,
 - iii. dërgimin e një instruksion shlyerjeje neto në sistemin AIPS;
 24. **Sistemi AIPS (Albanian Interbank Payment System – Sistemi i pagesave ndërbankare me vlerë të madhe)** – është sistemi i shlyerjes bruto, në kohë reale, të urdhërpagesave në lekë, me rëndësi sistemike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të paravokueshme dhe të pakushtëzuar;
 25. **Shlyerje ndër-OSHP** – është shlyerja në sistemin AIPS e rezultatit neto të klerimit të instruksioneve të debitimit direkt në sistemin AECH, kur OSHP-ja i debitorit dhe OSHP-ja i kreditorit nuk janë i njëjti OSHP, ose shlyerja e instruksioneve të debitimit direkt brenda OSHP-së, i cili është njëkohësisht OSHP i debitorit dhe OSHP i kreditorit;
 26. **Transaksioni i debitimit direkt** – është një kërkesë për debitim e autorizuar paraprakisht nga mandati, e lëshuar nga kreditori dhe e pagueshme nga llogaria e pagesës e debitorit në shumën dhe datën e përcaktuar në të;

27. **Transaksione të tipit R** – janë ato transaksione pagese të cilat nuk mund të ekzekutohen siç duhet nga një OSHP, ose që gjatë përpunimit të tyre rezultojnë në raste përjashtuese, ndër të tjera për shkak mungese fondesh, revokim, vlerë e gabuar ose datë e gabuar, mungesë e mandatit ose llogari e mbyllur apo e gabuar;
28. **Tarifë shkëmbimi** – është tarifë e paguar ndërmjet OSHP-së së debitorit dhe OSHP-së së kreditorit për transaksionet e debitimit direkt;
29. **Tarifë shumëpalëshe shkëmbimi** – është tarifë shkëmbimi, e cila është subjekt i një marrëveshjeje midis më shumë se dy OSHP-ve.

Neni 5

Mandati

1. Mandati mund të jetë në formë letër ose elektronike.
2. Mandati në formë letër mund të ruhet si i tillë, ose në trajtë të dixhitalizuar (mandati i dematerializuar).
3. Mandati në formë elektronike mund të jetë një dokument elektronik i nënshkruar duke përdorur një mënyrë ligjore të pranueshme dhe të rregulluar sipas legjislacionit për dokumentet elektronike.
4. Mandati, pavarësisht formës së tij, duhet të përmbajë tekstin e nevojshëm ligjor dhe emrat e palëve që e nënshkruajnë atë, duke u kujdesur që të përmbajë qartësisht shprehjen e pëlqimit dhe autorizimit të dhënë nga paguesi ndaj përfituesit dhe (direkt ose indirekt përmes përfituesit) ndaj OSHP-së së paguesit.
5. Kërkesat mbi elementet e detyrueshme të mandatit përcaktohen në Aneksin 2 (DS-01) bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Subjektet mund të marrin për shembull modelin e mandatit në formë letër të paraqitur në Aneksin 4.
6. Mandati plotësohet nga debitori, i cili ia dërgon atë kreditorit. Ky mandat duhet në çdo rast të nënshkruhet nga debitori si mbajtës i llogarisë, apo nga një person që zotëron një formë autorizimi (të tillë si prokurë) nga ana e debitorit për të nënshkruar mandatin në emër dhe për llogari të tij.
7. Kreditori mund t'i ofrojë debitorit një mjet të automatizuar për të plotësuar mandatin, duke përfshirë përdorimin e një nënshkrimi elektronik.
8. Në varësi të formës së tij, mandati nënshkruhet fizikisht ose në mënyrë elektronike nga debitori.
9. Për qëllime të kësaj rregulloreje, mandati i nënshkruar, pavarësisht formës së tij, ruhet për aq kohë sa nuk është anuluar, si dhe pas anulimit, mandati ruhet të paktën sa afati i përcaktuar në nenin 1022 të Kodit Civil, që debitori të marrë një rimbursim për një transaksion të paautorizuar.
10. Me marrjen e mandatit, kreditori duhet të kujdeset që të mos tjetërsojë përmbajtjen e mandatit, qoftë gjatë procesit të dematerializimit të mandatit në formë letër, qoftë gjatë procesit të marrjes së të dhënave nga dokumenti elektronik, kur mandati është në formë elektronike.
11. Të dhënat që i përkasin mandatit, duhet t'i transmetohen OSHP-së së kreditorit nga kreditori, së bashku me kërkesën për arkëtim të dërguar me anë të debitimit direkt.
12. Të dhënat e mandatit të dematerializuar duhet t'i transmetohen OSHP-së së debitorit nga OSHP-ja e kreditorit, si pjesë e çdo kërkesë për arkëtim.
13. OSHP-ja e kreditorit dhe OSHP-ja e debitorit kujdesen të përfshijnë në mënyrë të plotë në kushtet e punës të lidhura me marrëdhënien përkatëse me kreditorin dhe debitorin, të gjitha kërkesat e mësipërme që duhet detyrimisht të plotësohen përkatësisht nga kreditori dhe debitori në lidhje me përmbajtjen, plotësimin,

përpunimin, ruajtjen, lëvizjen dhe transmetimin e mandatit dhe të dhënave përkatëse.

Neni 6

Kushtet për anulimin ose ndryshimin e mandatit

1. Mandati mund të anulohet ose të ndryshohet në çdo kohë nga debitori si mbajtës i llogarisë, apo nga një person që zotëron një formë autorizimi nga ana e debitorit për të vepruar në emër dhe për llogari të tij.
2. Mandati mund të anulohet ose ndryshohet pasi debitori, ose personi i autorizuar prej tij, njofton kreditorin me shkrim apo me mjete të tjera të sigurta të komunikimit elektronik për anulimin apo ndryshimin e mandatit.
3. Njoftimi duhet të identifikojë mandatin që kërkohet të anulohet ose ndryshohet.
4. Anulimi ose ndryshimi i një mandati nuk ndikon mbi të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga mandati përpara se urdhri për anulimin ose ndryshimin e mandatit të bëhet efektiv.
5. Urdhri për anulimin ose ndryshimin e mandatit bëhet efektiv kur atë e merr OSHP-ja e debitorit.
6. Mandati konsiderohet automatikisht i anuluar kur kalon afatin maksimal të periudhës së inaktivitetit të përcaktuar në Aneksin 3, bashkëlidhur kësaj rregullore, në parametrin “periudha e inaktivitetit” që prej datës së fundit të përdorimit të tij.

Neni 7

Transaksionet e tipit “R”

1. Transaksionet e debitimit direkt, të cilat shmangen nga rregulli i përgjithshëm i ekzekutimit të tyre, rezultojnë në rastet përjashtuese si më poshtë:
 - a) “*Reject*” (mospranim) – kërkesa për arkëtim nuk pranohet për ekzekutim si rezultat i devijimit nga ekzekutimi normal përpara shlyerjes ndër-OSHP, për arsye të mëposhtme:
 - i. arsye teknike të zbuluara nga OSHP-ja e kreditorit, OSHP-ja e debitorit, ose sistemi i klerimit dhe shlyerjes,
 - ii. OSHP-ja e debitorit e ka të pamundur ta pranojë për arsye të tjera,
 - iii. debitori i ka bërë kërkesë për refuzim OSHP-së së debitorit, dhe OSHP-ja e debitorit do të gjenerojë një mospranim;
 - b) “*Return*” (kthim) – kërkesa për arkëtim devijohet nga ekzekutimi normal pas shlyerjes ndër-OSHP dhe një kthim inicohet nga OSHP-ja e debitorit;
 - c) “*Refusal*” (refuzim) – pretendim i ngritur nga debitori përpara shlyerjes për arsye të ndryshme, duke i kërkuar OSHP-së së debitorit të mos paguajë kërkesën për arkëtim. OSHP-ja e debitorit duhet ta trajtojë refuzimin në përputhje me marrëveshjen që ka me debitorin. Në varësi të momentit kur OSHP-ja e debitorit trajton refuzimin, ai përpunohet në një nga veprimet e mëposhtme:
 - i. kur OSHP-ja e debitorit vendos ta trajtojë pretendimin përpara shlyerjes ndër-OSHP, rezulton në veprim mospranimi,
 - ii. kur OSHP-ja e debitorit vendos ta trajtojë pretendimin pas shlyerjes ndër-OSHP, rezulton në veprim kthimi;
 - d) “*Reversal*” (veprim me kah të kundërt) – kreditori del në përfundimin se një kërkesë për arkëtim nuk duhet të ishte procesuar, dhe si rezultat i këtij ekzekutimi, pas shlyerjes, kreditori mund të përdorë një veprim me kah të kundërt për të rimbursuar debitorin për vlerën e plotë të kërkesës së ekzekutuar gabimisht. Në raste të tilla vlejnë rregullat e mëposhtme:

- i. OSHP-ja e kreditorit nuk është i detyruar t'i ofrojë kreditorit funksionalitetin/shërbimin e veprimit me kah të kundërt,
 - ii. OSHP-ja e debitorit është i detyruar të trajtojë veprimet me kah të kundërt të iniciuara nga kreditorët ose OSHP të kreditorëve,
 - iii. Kreditorët nuk janë të detyruar të përdorin funksionalitetin e veprimit me kah të kundërt, por nëse e bëjnë atë, një veprim me kah të kundërt i iniciuar nga kreditori (kur ofrohet nga OSHP i kreditorit) duhet të trajtohet nga OSHP-ja e kreditorit dhe OSHP-ja e debitorit,
 - iv. Veprimi me kah të kundërt mund të iniciohet edhe nga OSHP-ja e kreditorit për të njëjtat arsye,
 - v. OSHP-ja e debitorit nuk nevojitet të kryejë kontrolle mbi veprimet me kah të kundërt të mbërritur;
- e) “*Revocation*” (revokim) – kërkesë e kreditorit për të tërhequr mbrapsht instruksionin e kërkesës për arkëtim brenda një date të rënë dakord me OSHP-në e kreditorit, si pjesë e marrëveshjes midis kreditorit dhe OSHP-së së kreditorit;
- f) “*Request for cancellation*” (anulim) – kërkesë e OSHP-së së kreditorit për të tërhequr mbrapsht instruksionin e kërkesës për arkëtim përpara shlyerjes, si pjesë e marrëveshjes midis OSHP-së së kreditorit dhe operatorit të sistemit të klerimit dhe shlyerjes;
- g) “*Refund*” (rimbursim) – pretendim i debitorit për rimbursim të një debitimi direkt. Lidhur me rimbursimin, vlejné rregullat e mëposhtme:
- i. rimbursimi është i vlefshëm si për debitimet direkte të autorizuara, ashtu edhe ato të paautorizuara,
 - ii. kërkesa për rimbursim i dërgohet OSHP-së së debitorit pas shlyerjes, sipas kushteve të përcaktuara nga kjo rregullore dhe brenda afateve të përcaktuara në Aneksin 3,
 - iii. OSHP-ja e debitorit ka të drejtë të marrë kompensim, të quajtur kompensim i rimbursimit, nga OSHP-ja e kreditorit për pjesën përkatëse të interesit të humbur nga OSHP-ja e debitorit sipas kushteve të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Veprimet “mospranim”, “kthim” dhe “rimbursim” të kërkesave për arkëtim duhet të klerohen dhe shlyhen përkatësisht në sistemet AECH dhe AIPS ku klerohen dhe shlyhen kërkesat fillestare për arkëtim, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe midis OSHP-ve të përfshirë, si dhe rastit kur OSHP-ja e debitorit dhe OSHP-ja e kreditorit janë e njëjta OSHP.
3. Në rastet kur një nga palët e përfshira në transaksionin e debitimit direkt, për ndonjë arsye, nuk mund të trajtojë kërkesën për arkëtim në rrugë normale, procesi i trajtimit të rasteve përjashtuese fillon në pikën e procesit ku është hasur problemi.

Neni 8

Kushtet bazë për paraqitjen e kërkesës për arkëtim

1. Kreditori mund të paraqesë një kërkesë për arkëtim, nëse përmbush kushtet e mëposhtme:
 - a) i është caktuar një “ID e kreditorit” nga Banka e Shqipërisë;
 - b) ka një pretendim të vlefshëm ndaj debitorit për të mbledhur (arkëtuar) para, në bazë të një kontrate ose marrëveshjeje midis kreditorit dhe debitorit;
 - c) ka marrë një mandat të debitimit direkt të nënshkruar nga debitori për këtë qëllim;

- d) i ka dërguar OSHP-së së kreditorit një kopje të mandatit, si dhe sa herë që ky ndryshohet nga debitori.
2. Kërkesa për arkëtim plotësohet sipas formatit të përcaktuar nga OSHP-ja e kreditorit, i cili duhet të ketë në përmbajtje të tij elementet e përcaktuara në Aneksin 2 (DS-03).

Neni 9

Kushtet për revokim të kërkesës për arkëtim

1. Një kërkesë për arkëtim mund të revokohet me urdhër të dhënë nga kreditori si dërgues i kërkesës për arkëtim, ose nga një person që zotëron një formë autorizimi nga ana e kreditorit për të vepruar në emër të tij.
2. Nëse urdhri për revokim të kërkesës për arkëtim merret nga OSHP-ja e kreditorit në kohën dhe në mënyrën që i jep mundësi të kryejë revokimin e instruksionit, përpara se instruksioni origjinal i debitimit direkt të jetë dërguar në sistemin AECH, atëherë OSHP-ja e kreditorit duhet të marrë masat për revokimin e kërkesës për arkëtim pa vijuar me dërgimin e mëtejshëm të transaksionit të debitimit direkt në sistemin AECH.
3. Komunikimi i urdhrimit për revokimin e kërkesës për arkëtim mund të kryhet me shkrim nga kreditori për OSHP-në e kreditorit.
4. Në qoftë se OSHP-ja e kreditorit ofron për kreditorin shërbimin e komunikimit elektronik sipas një infrastrukture të sigurt, atëherë komunikimi i urdhrimit për revokimin e kërkesës për arkëtim konsiderohet si i vlefshëm edhe nëse kryhet nëpërmjet këtij kanali komunikimi.
5. Urdhri duhet të identifikojë kërkesën për arkëtim që kërkohet të revokohet.
6. Urdhri për revokimin e kërkesës për arkëtim bëhet efektiv kur ai merret nga OSHP-ja e kreditorit në formë shkresore ose nëpërmjet shërbimit të komunikimit elektronik të pranuar midis OSHP-së së kreditorit dhe kreditorit.

Neni 10

Trajtimi i datave të veçanta

1. Në kushte të zakonshme, data e detyrimit, data e shlyerjes dhe data e debitimit, janë e njëjta datë, bazuar në plotësimin e supozimeve të mëposhtme:
 - a) kërkesa për arkëtim përmban një datë detyrimi në përputhje me këtë rregullore;
 - b) OSHP-ja e debitorit dhe OSHP-ja e kreditorit dhe sipas rastit OSHP-të ndërmjetësues, e kanë të mundur të dërgojnë për shlyerje veprimin në datën e detyrimit;
 - c) sistemet AECH dhe AIPS janë të hapura në datën e detyrimit;
 - d) OSHP-ja e debitorit është e gatshme të debitojë llogarinë e debitorit me vlerën e kërkesës për arkëtim në datën e detyrimit.
2. Nëse për ndonjë arsye, kërkesa për arkëtim vonohet dhe data e detyrimit është e tillë që bëhet e pamundur për marrjen e kërkesës për arkëtim nga OSHP-ja e debitorit sipas kësaj rregulloreje, atëherë data e detyrimit zëvendësohet me datën më të afërt të mundshme si datë e re e detyrimit nga kreditori ose OSHP-ja e kreditorit sipas marrëveshjes midis tyre.
3. Nëse data e detyrimit bie në një ditë që nuk është ditë pune ndërbankare, atëherë data e shlyerjes do të jetë dita e punës ndërbankare pasardhëse.
4. Nëse data e shlyerjes bie në një ditë që nuk është ditë pune për OSHP-në e debitorit, atëherë data e debitimit do të jetë dita e punës pasardhëse e OSHP-së së debitorit.
5. Nëse OSHP-ja e debitorit nuk mund të debitojë llogarinë e debitorit në datën e detyrimit, atëherë debitimi mund të ekzekutohet më vonë, por OSHP-ja e debitorit

duhet në çdo rast të realizojë veprimin e kthimit në kohë, në mënyrë që të respektojë rregullin se kthimet duhet të shlyhen maksimumi deri aq kohë pas datës së detyrimit sa afati i përcaktuar në Aneksin 3 në parametrin “shlyerja e kthimeve”.

Neni 11

Njoftimi paraprak i debitorit

1. Njoftimet paraprake që kreditori i jep debitorit në lidhje me kërkesën për arkëtim duhet të përmbushin kushtet e mëposhtme.
 - a) Kur mandati jepet për shuma fikse të përcaktuara në kërkesën për arkëtim, dhe të debitueshme në intervale të caktuara kohe, kreditori njofton debitorin, me anë të mjeteve të komunikimit të dakordësuara midis palëve, për vlerën që duhet të debitohet dhe datën e debitimit të llogarisë, në afat të paktën aq kohë përpara datës së detyrimit të transaksionit të parë të debitimit direkt, sa afati i përcaktuar në Aneksin 3 në parametrin “njoftimi paraprak”. Një njoftim i tillë jepet sa herë që ka një ndryshim në shumën ose datën e pagesës.
 - b) Kur mandati jepet për shuma të ndryshueshme të përcaktuara në kërkesën për arkëtim, dhe të debitueshme në intervale të ndryshme kohe, kreditori njofton debitorin, me anë të mjeteve të komunikimit të dakordësuara midis palëve, për vlerën që duhet të debitohet dhe datën e debitimit të llogarisë, në afat të paktën aq kohë përpara datës së detyrimit të transaksionit të çdo kërkesë për arkëtim, sa afati i përcaktuar në Aneksin 3 në parametrin “njoftimi paraprak”.

KREU II

DETYRIMET DHE MARRËDHËNIET MIDIS PALËVE

Neni 12

Detyrimi për të informuar

1. OSHP-ja e debitorit dhe OSHP-ja e kreditorit përkatësisht duhet t'i japin paraprakisht debitorit dhe kreditorit informacion të qartë, aktual dhe të mjaftueshëm në lidhje me kushtet për inicimin dhe ekzekutimin e transaksionit të debitimit direkt sipas parashikimeve të ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
2. Kushtet për inicimin dhe ekzekutimin e transaksionit të debitimit direkt përshkruajnë të paktën informacionin e mëposhtëm:
 - a) periudhën kohore përpara datës së shlyerjes brenda së cilës paraqitet kërkesa për arkëtim;
 - b) datën e kreditimit të llogarisë së pagesës së kreditorit me OSHP-në e kreditorit për vlerën e përcaktuar në kërkesën për arkëtim;
 - c) vlerën dhe mënyrën e llogaritjes së komisioneve të pagueshme nga debitori/kreditori për përpunimin dhe ekzekutimin e transaksionit të debitimit direkt;
 - d) datën e detyrimit në të cilën do të debitohet llogaria e pagesës e debitorit me OSHP-në e debitorit për vlerën e përcaktuar në kërkesën për arkëtim;
 - e) detaje mbi kushtet dhe procedurat për ngritjen e pretendimeve për rimbursimet e debitorit, si dhe mbi ankimin.

Neni 13

Miratimi i kreditorit nga OSHP-ja e kreditorit

1. Përpara miratimit të një kreditori, OSHP-ja përkatëse vlerëson rrezikun e kredisë së kreditorit të mundshëm dhe sigurohet se fuqia financiare, integriteti dhe besueshmëria e tij janë në një nivel të tillë, i cili e kualifikon atë për të qenë kreditor.
2. OSHP-ja e kreditorit informon kreditorin për detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore, përfshirë ato mbi përmbajtjen e mandatit dhe ruajtjen e tij.
3. OSHP-ja e kreditorit duhet të sigurohet se kreditori që miraton, përmbush të gjitha përgjegjësitë dhe detyrimet e përcaktuara në lidhje me kreditorin në këtë rregullore dhe i plotëson ato në vijimësi.

Neni 14

Detyrimet e OSHP-së së kreditorit

Kur një OSHP-ja vendos të veprojë si OSHP i kreditorit ai duhet të përmbushë detyrimet e mëposhtme:

1. të kontrollojë mandatin e përcjellë nga kreditori, si dhe çdo ndryshim të tij, përpara se kreditori të dërgojë kërkesën për arkëtim, për t'u siguruar që mandati përmbush kërkesat e përcaktuara në rregullore;
2. të rimbursojë Bankën e Shqipërisë, si operator i sistemit AECH dhe pjesëmarrësit e tjerë për çdo humbje të drejtpërdrejtë, kosto, apo dëm të ardhur si pasojë e mospërmbushjes nga mandati të kërkesave të përcaktuara në rregullore;
3. të lidhë marrëveshje me kreditorët e tij për ofrimin dhe përdorimin e shërbimit të debitimit direkt, në përputhje me këtë rregullore, vetëm pasi të ketë zbatuar parimet e “Njih Klientin Tënd”, si dhe të sigurohet se ajo marrëveshje:
 - a) është në përputhje me këtë rregullore, e plotë, e shprehur qartë dhe e zbatueshme,
 - b) përmban parashikimet e duhura për rastet kur një kreditor zhvendos llogarinë e tij nga një OSHP e kreditorit tek një tjetër,
 - c) përmban parashikimet e duhura për rastet e ndryshimeve në statusin e OSHP-së si pasojë e një bashkimi, blerjeje etj. të OSHP-së nga një subjekt tjetër;
4. të mos kufizojë kreditorët e tij nga marrja e shërbimeve të ngjashme nga çdo OSHP tjetër;
5. përpara inicimit të parë të një debitimi direkt, t'u sigurojë kreditorëve aktualë dhe atyre të ardhshëm informacionin e duhur dhe të nevojshëm mbi rreziqet e tyre, si dhe mbi të drejtat dhe detyrimet përkatëse të debitorit, kreditorit dhe OSHP-së së kreditorit përfshirë këtu edhe të drejtat dhe detyrimet e pacaktuara në legjislacionin në fuqi për debitimin direkt në fjalë, si dhe në përgjithësi informacion në lidhje me përdorimin e sigurt të debitimit direkt;
6. të qëndrojë në përputhje me udhëzime të aplikueshme të paraqitura në vijimësi në lidhje me administrimin e rrezikut;
7. në rast se një kreditor i ardhshëm nuk ka marrë ID-në e kreditorit, të ndjekë caktimin e tij;
8. të kryejë të gjitha detyrat operationale të caktuara për OSHP-në e kreditorit në përputhje me këtë rregullore;
9. të pranohet instruksione kërkesë për arkëtim nga kreditori që përputhen me përcaktimet në këtë rregullore dhe anekset e saj;
10. të përpusojë transaksionet që shmangen nga rregulli i përgjithshëm në përputhje me këtë rregullore dhe anekset e saj;
11. të paguajë shumën e secilit rimbursim ose kthim në OSHP-në përkatës të debitorit, pavarësisht statusit të llogarisë së kreditorit ose vetë kreditorit;
12. me kërkesë të një OSHP-je të debitorit të cilit i ka dërguar një kërkesë për arkëtim (përfshirë ndonjë kërkesë për arkëtim, e cila është bërë objekt i një mospranimi), të

- kërkojë të gjithë informacionin përkatës dhe nëse kërkohet, një kopje të mandatit përkatës nga kreditori, dhe pa vonesa të panevojshme, t'ia dorëzojë OSHP-së së debitorit atë informacion në lidhje me kërkesën për arkëtim dhe mandatin përkatës, ashtu siç është vënë në dispozicion të tij nga kreditori përkatës;
13. të monitorojë përdorimin e debitimit direkt nga kreditorët e tij, për të siguruar pajtueshmëri të vazhdueshme me këtë rregullore, në mënyrë që të zbuten të gjitha rreziqet;
 14. në rast se ka prova të besueshme se kreditori i tij ka kryer ose tenton të kryejë një ose më shumë debitime direkte, me qëllim për të mashtruar ndonjë person, të pushojë menjëherë kryerjen e kërkesave për arkëtime të mëtejshme për një kreditor të tillë;
 15. të sigurojë në marrëveshjet e tij me kreditorët, ku rregullohet përdorimi i shërbimeve sipas rregullores, që ai të ketë të drejtë të ndërprisë të tilla marrëveshje, në rast se kreditorët keqpërdorin rregullat e funksionimit dhe që ai e ushtron këtë të drejtë në një rast të tillë;
 16. të paguajë kompensim ndaj OSHP-së së debitorëve në lidhje me rimbursimet, siç përcaktohet në përputhje me këtë rregullore;
 17. të raportojë menjëherë dhe pa vonesë pranë operatorit të sistemit AECH, në lidhje me rreziqe të pazbutura, të cilat kanë ndikim të rëndësishëm mbi mënyrën e funksionimit të shërbimit të debitimit direkt, si dhe për incidente madhore që ndikojnë në funksionimin e tij;
 18. të raportojë menjëherë dhe pa vonesë pranë operatorit të sistemit AECH, mbi çështje apo ankesa të ngritura nga debitorë ose kreditorë në lidhje me kërkesa për arkëtim, si dhe mbi gjetje të auditorit të brendshëm ose të jashtëm, kur çështje, ankesa ose gjetje të tilla kanë ndikim të rëndësishëm mbi mënyrën e funksionimit të shërbimit të debitimit direkt;
 19. të respektojë afatet kohore të përcaktuara në këtë rregullore për transmetimin e instruksioneve të lidhura me debitimin direkt;
 20. të informojë kreditorin mbi afatet kohore që janë subjekt i marrëveshjes midis tyre dhe të cilat duhet të respektohen për kërkesat për arkëtim;
 21. të detyrojë çdo kreditor të tij që të qëndrojë, në përputhje me kërkesat që i përkasin sipas kësaj rregulloreje:
 - a) të sigurojë dhe të përdorë një ID kreditori kur kryen debitim direkt,
 - b) të përdorë një mandat që është në përputhje me kërkesat e përcaktuara,
 - c) të veprojë në përputhje me kushtet e mandateve të dakordësuara me debitorët e tij,
 - d) të mbledhë, të përpunojë dhe të ruajë të dhëna në lidhje me mandatat e tij në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje,
 - e) të njoftojë paraprakisht debitorët e tij në lidhje me kërkesat për arkëtim të cilat propozon të iniciojnë në përputhje me mandatin përkatës,
 - f) të iniciojë kërkesa për arkëtim me OSHP-në e kreditorit në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në këtë rregullore dhe Aneksin 3,
 - g) të kryejë të gjitha detyrat operationale të caktuara për kreditorët sipas kësaj rregulloreje,
 - h) të kryejë të gjitha mospranimet, kthimet dhe rimbursimet në lidhje me kërkesat për arkëtim të cilat i paraqiten përmes OSHP-së së kreditorit,
 - i) t'i sigurojë pa vonesë OSHP-së së kreditorit, informacion në lidhje me kërkesat për arkëtim dhe mandatat, dhe një kopje të çdo mandati, kur i kërkohet nga OSHP-ja e kreditorit,

- j) të qëndrojnë në përputhje me udhëzime të paraqitura në vijimësi në lidhje me administrimin e rrezikut për kreditorët,
 - k) të zgjidhë çdo mosmarrëveshje në lidhje me kontratat dhe pagesat përkatëse drejtpërdrejt me debitorin;
22. në rast se një OSHP e debitorit ka pësuar humbje si rezultat i kryerjes së një rimbursimi në përputhje me këtë rregullore, dhe OSHP-ja përkatëse e kreditorit nuk dëmshpërblen OSHP-në e debitorit për këtë humbje në përputhje me këtë rregullore, atëherë OSHP-ja e debitorit ka të drejtë të marrë përfitim të plotë ose të pjesshëm, nëpërmjet transferimit ose në një mënyrë tjetër, të të drejtave të OSHP-së së kreditorit ndaj kreditorit përkatës, dhe OSHP-ja e kreditorit duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshëm për të siguruar një të drejtë të tillë për OSHP-në e debitorit.
23. OSHP-ja e kreditorit do të dëmshpërblejë OSHP-në e debitorit për humbjen financiare të shkaktuar në rast të një kërkesë për rimbursim të përmbushur nga OSHP-ja e debitorit sipas kësaj rregulloreje.

Neni 15

Detyrimet e OSHP-së eë debitorit

Kur një OSHP vendos të veprojë si OSHP e debitorit, ajo duhet të përmbushë detyrimet e mëposhtme:

1. të regjistrojë me saktësi marrjen dhe pranimin e mandatit në bazën e të dhënave të debitimeve direkte të klientëve të tij;
2. të lidhë marrëveshje me debitorët e tij për ofrimin dhe përdorimin e shërbimit të debitimit direkt, në përputhje me këtë rregullore, vetëm pasi të ketë zbatuar parimet e “Njih Klientin Tënd”, si dhe të sigurohet se ajo marrëveshje:
 - a) është në përputhje me këtë rregullore, e plotë, e shprehur qartë dhe e zbatueshme,
 - b) përmban parashikimet e duhura për rastet kur një debitor zhvendos llogarinë e tij nga një OSHP e debitorit tek një tjetër,
 - c) përmban parashikimet e duhura për rastet e ndryshimeve në statusin e OSHP-së si pasojë e një bashkimi, blerjeje etj. të OSHP-së nga një subjekt tjetër;
3. përpara inicimit të parë të një debitimi direkt, t’u sigurojë debitorëve aktualë dhe atyre të ardhshëm informacionin e duhur dhe të nevojshëm mbi rreziqet e tyre, si dhe mbi të drejtat dhe detyrimet përkatëse të debitorit, kreditorit dhe OSHP-së së debitorit, përfshirë këtu edhe të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në legjislacionin për shërbimet e pagesave dhe debitimin direkt në fjalë, si dhe në përgjithësi informacion në lidhje me përdorimin e sigurt të debitimit direkt;
4. të lejojë debitorët të ndalojnë zbatimin e debitimeve direkte në llogaritë e tyre;
5. t’i japë mundësinë debitorit të instruktojë OSHP-në e tij, që:
 - a) të vendosë kufizime për vlerën dhe/ose periodicitetin e kërkesave për arkëtim në drejtim të tij,
 - b) të bllokojë çdo debitim direkt në llogarinë e pagesës së debitorit, ose të bllokujë çdo debitim direkt të iniciuar nga një ose më shumë kreditorë të caktuar, ose të autorizojë debitime direkte të iniciuara vetëm nga një ose më shumë kreditorë të caktuar;
6. OSHP-ja e debitorit ka detyrimin të informojë debitorin mbi çdo të drejtë që i lind atij nga kjo rregullore, si dhe kushtet e veçanta të marrëdhënies midis debitorit dhe OSHP-së së tij;
7. të qëndrojnë, në përputhje me udhëzime të aplikueshme të paraqitura në vijimësi, në lidhje me administrimin e rrezikut;

8. të kryejë të gjitha detyrat operacionale të caktuara për OSHP-në e debitorit në përputhje me këtë rregullore dhe anekset e saj;
9. të kryejë të gjitha mospranimet, kthimet dhe rimbursimet në lidhje me llogarinë e debitorit, në përputhje me këtë rregullore, edhe nëse llogaria e debitorit është e mbyllur;
10. të kryejë rimbursimet e kërkuara nga debitori pas mbylljes së llogarisë së tij në OSHP-në e debitorit, në përputhje me këtë rregullore;
11. nëse kërkohet nga një debitor për të cilin ka mbërritur një kërkesë për arkëtim, të kërkojë të gjithë informacionin përkatës dhe një kopje të mandatit përkatës nga OSHP-ja e kreditorit, dhe pa vonesa të panevojshme, t'ia dorëzojë debitorit atë informacion në lidhje me mandatin përkatës, ashtu siç i është vënë në dispozicion nga OSHP-ja e kreditorit;
12. të raportojë menjëherë dhe pa vonesë pranë operatorit të sistemit AECH, në lidhje me rreziqe të pa zbutura, të cilat kanë ndikim të rëndësishëm mbi mënyrën e funksionimit të shërbimit të debitimit direkt, si dhe për incidente madhore që ndikojnë në funksionimin e tij;
13. të raportojë menjëherë dhe pa vonesë pranë operatorit të sistemit AECH, mbi çështje apo ankesa të ngritura nga debitorë ose kreditorë në lidhje me kërkesa për arkëtim, si dhe mbi gjetje të auditorit të brendshëm ose të jashtëm, kur çështje, ankesa ose gjetje të tilla kanë ndikim të rëndësishëm mbi mënyrën e funksionimit të shërbimit të debitimit direkt;
14. të detyrojë çdo debitor të tij që të qëndrojë në përputhje me kërkesat që i përkasin sipas kësaj rregulloreje:
 - a) të veprojë në përputhje me kushtet e mandateve të dakordësuara me kreditorët e tij,
 - b) të kërkojë rimbursime vetëm në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në këtë rregullore dhe Aneksin 3,
 - c) të zgjidhë çdo mosmarrëveshje në lidhje me një kërkesë për arkëtim drejtpërdrejt me kreditorin në fjalë, dhe të pranojë që detyrimet e OSHP-së së debitorit dhe OSHP-së së kreditorit sipas kësaj rregulloreje nuk i nënshtrohen pretendimeve ose mbrojtjeve sipas kontratave ose marrëveshjeve të tjera në fuqi të lidhura midis debitorit dhe kreditorit.

Neni 16

Marrëdhëniet midis palëve

1. Palët e përfshira në realizimin e instruksioneve të debitimit direkt janë:
 - a) kreditori si përfitues i pagesës;
 - b) debitori si pages;
 - c) OSHP-ja e kreditorit si mbajtëse e llogarisë së pagesës së kreditorit;
 - d) OSHP-ja e debitorit si mbajtëse e llogarisë së pagesës së debitorit;
 - e) sistemi AECH si sistemi ku klerohen instruksionet e debitimit direkt;
 - f) sistemi AIPS si sistemi ku shlyhen rezultatet e klerimit të instruksioneve të debitimit direkt;
 - g) OSHP-ja ndërmjetësuese si ofruese shërbimi të ndërmjetëm midis dy OSHP-ve të cilat nuk janë pjesëmarrëse në sistemin AECH.
2. Sistemi AECH ofron shërbimin e klerimit të instruksioneve të debitimit direkt për pjesëmarrësit e tij.
3. OSHP-ja e kreditorit mund të ofrojë shërbimin e debitimit direkt për kreditorin, në kuadër të pjesëmarrjes së OSHP-së së kreditorit në sistemin AECH dhe shërbimin përkatës të klerimit të instruksioneve të debitimit direkt.

4. OSHP-ja e debitorit mund të ofrojë shërbimin e debitimit direkt për debitorin, në kuadër të pjesëmarrjes së OSHP-së së debitorit në sistemin AECH dhe shërbimin përkatës të klerimit të instruksioneve të debitimit direkt.
5. Një OSHP që nuk është pjesëmarrëse në sistemin AECH, mund të ofrojë shërbimin e debitimit direkt për klientët e tij, nëpërmjet një OSHP-je ndërmjetësuese, e cila nga ana e saj është pjesëmarrëse në sistemin AECH, si dhe shërbimin përkatës të klerimit të instruksioneve të debitimit direkt.
6. OSHP-të transmetojnë/ekzekutojnë transaksionet e debitimit direkt, duke përdorur IBAN-in si kod të identifikimit të llogarisë së pagesës. Ato sigurojnë që PSHP-të të mund të përdorin IBAN-in për identifikimin e llogarive të pagesës që mund të kenë me OSHP-të.
7. OSHP-ja e kreditorit dhe kreditori lidhin marrëveshje midis tyre, në të cilën përcaktohen qartë termat dhe kushtet e përdorimit të shërbimit të debitimit direkt të ofruar për kreditorin nga OSHP-ja e kreditorit.
8. OSHP-ja e debitorit dhe debitori lidhin marrëveshje midis tyre, në të cilën përcaktohen qartë termat dhe kushtet e përdorimit të shërbimit të debitimit direkt të ofruar për debitorin nga OSHP-ja e tij.
9. Çdo OSHP e cila ofron shërbimin e debitimit direkt për klientët e tij nëpërmjet një OSHP-je ndërmjetësuese pjesëmarrëse në AECH, duhet të lidhë marrëveshje me OSHP-në ndërmjetësues, në të cilën të përcaktohen qartë termat dhe kushtet e përdorimit të shërbimit të debitimit direkt të ofruar nga OSHP-ja ndërmjetësuese.
10. Çdo OSHP pjesëmarrëse në sistemin AECH, e cila pranon të përdorë shërbimin e klerimit të instruksioneve të debitimit direkt, nëpërmjet marrëveshjes së pjesëmarrjes në sistemin AECH, pranon të gjitha kushtet dhe detyrimet në lidhje me përdorimin e shërbimit të debitimit direkt të ofruar në AECH, si dhe zbaton të gjitha rregulloret e lidhura me sistemin AECH dhe debitimin direkt, përfshirë këtë rregullore dhe anekset e saj.
11. Çdo OSHP e cila ofron shërbimin e debitimit direkt në kuadër të pjesëmarrjes së saj në sistemin AECH, qoftë për subjekte debitore ose kreditore, qoftë për OSHP të tjera të cilat do ta ofrojnë atë shërbim për klientët përkatës, duhet të sigurojë nëpërmjet kushteve dhe termave të marrëveshjeve me këto palë, se të gjitha rregullat dhe detyrimet e përcaktuara nga kjo rregullore dhe rregulloret e sistemit AECH, do të zbatohen nga palët e lidhura në marrëveshje dhe se vetë ato palë do të duhet të sigurojnë që të kërkohet gjithashtu në mënyrë zinxhir, një zbatim i tyre nga çdo palë tjetër me të cilën ata do të lidhin marrëveshje në vijim për ofrimin e një shërbimi të tillë.
12. Nëpërmjet marrëveshjeve përkatëse, palët bien dakord, veç të tjerash, edhe në lidhje me termat kohorë të ekzekutimit të transaksioneve, oraret e pranueshme të tyre gjatë ditës së punës, komisionet që aplikohen për realizimin e veprimeve të debitimit direkt, si dhe mënyrën e trajtimit të rasteve përjashtuese që rezultojnë nga transaksione të cilat shmangen nga rregulli i përgjithshëm i ekzekutimit të tyre.
13. Çdo kusht i vendosur në marrëdhëniet midis palëve në lidhje me termat kohorë të ekzekutimit të transaksioneve, apo në lidhje me aspekte të administrimit të dokumentacionit dhe shkëmbimit të informacionit, të dërgimit të instruksioneve ndërmjet palëve, si dhe me aspekte të komunikimit midis tyre, është subjekt i marrëveshjeve përkatëse përtej kësaj rregulloreje, por që nuk duhet në asnjë rast të bjerë në kundërshtim me parimet dhe termat e përcaktuar në këtë rregullore, apo me mënyrën e funksionimit të shërbimit të debitimit direkt në sistemin AECH dhe përcaktimet në rregulloren përkatëse.

14. Secila nga marrëveshjet e sipërpërmendura është subjekt i negocimit midis palëve përkatëse përtej kësaj rregulloreje, por duhet të garantojë se përmban të paktën elementet detyruese të shprehura në këtë rregullore dhe aktet e tjera të lidhura me ofrimin e shërbimit të klerimit të debitimit direkt në sistemin AECH, si dhe të shlyerjes në AIPS.

Neni 17

Shkëmbimi i informacionit dhe verifikimi

1. Informacioni dhe instruksionet e lidhura me debitimin direkt shkëmbehen midis palëve në formate të përshtatshme për të cilat është rënë dakord në marrëveshjet midis tyre, si dhe në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe anekseve të saj.
2. Në çdo transaksion debitimi direkt, pavarësisht OSHP-së, kodi i identifikimit të llogarisë së pagesës paraqitet në instruksione në formatin IBAN.
3. Në të gjitha rastet, palët kujdesen për shkëmbimin e informacionit në mënyrë të sigurt, duke garantuar në të dy drejtimet sigurinë, autenticitetin dhe integritetin e tij.
4. Palët bien dakord për procedurat e dërgimit dhe pranimit të secilit instruksion të shkëmbyer, si dhe, aty ku është e aplikueshme, për verifikimet që do të kryejnë për garantimin e autenticitetit dhe integritetit të informacionit.
5. Varësisht nga mënyra e komunikimit të informacionit në trajtë shkresore ose elektronike, nënshkrimet e dokumenteve verifikohen nëpërmjet një procedure të sigurt të shkëmbimit dhe verifikimit të nënshkrimeve të autorizuar.

KREU III PROCESET

Neni 18

Lëshimi i mandatit

1. Lëshimi i mandatit dhe nënshkrimi i tij është një proces që realizohet midis kreditorit dhe debitorit. Ai kryhet në formë letër ose elektronike, me një format të mandatit të pranuar midis kreditorit dhe debitorit dhe që plotëson kushtet e përcaktuara në këtë rregullore, në lidhje me mandatin dhe informacionin e paraqitur në të.
2. Iniciativa për lëshimin e mandatit mund të ndërmerret si nga kreditori ashtu edhe nga debitori.
3. Kreditori sigurohet që dokumenti i mandatit përmban tekstin e nevojshëm ligjor për autorizimin dhe të drejtat për rimbursim, si dhe cakton referencën unike të mandatit.
4. Plotësimi i formatit të pranuar të mandatit me të dhënat e nevojshme kryhet si më poshtë:
 - a) nëse mandati gjenerohet nga kreditori, i dërgohet debitorit bazuar në marrëveshje midis tyre;
 - b) debitori merr mandatin e gjeneruar paraprakisht nga kreditori, e plotëson me të dhënat e nevojshme të debitorit, e nënshkruan atë, dhe ia dërgon kreditorit;
 - c) kreditori finalizon mandatin dhe e pranon atë.
5. Debitori dhe kreditori duhet të sigurojnë plotësimin e informacionit të detyrueshëm në mandat sipas përkatësisë, në përputhje me Aneksin 2 (DS-01).
6. Në qoftë se referenca unike e mandatit nuk është e vendosur në momentin e nënshkrimit të mandatit, ajo duhet të përcaktohet nga kreditori për debitorin përpara inicimit të kërkesës së parë për arkëtim.

7. Pas pranimit të mandatit, kreditori duhet të dematerializojë mandatin në përputhje me Aneksin 2 (DS-02), si dhe të arkivojë dokumentin sipas përcaktimeve ligjore, për një periudhë kohe të paktën sa periudha e rimbursimit e përcaktuar për një transaksion të paautorizuar.
8. Mandati quhet i lëshuar pas regjistrimit të tij nga kreditori dhe përpara inicimit të kërkesës së parë për arkëtim.
9. Kreditori dërgon informacionin e mandatit tek OSHP-ja e kreditorit si pjesë e çdo kërkesë për arkëtim.

Neni 19

Ndryshimi i mandatit

1. Arsyet për ndryshimin e mandatit mund të jenë si më poshtë:
 - a) përcaktimi i një reference të re unike të mandatit nga ana e kreditorit;
 - b) caktimi i një ID-je kreditori të re;
 - c) ndryshimi i emrit të kreditorit;
 - d) përcaktimi nga debitori i një llogarie tjetër për debitimin në të njëjtin OSHP ose në një OSHP tjetër;
 - e) një kombinim i arsyeve të mësipërme.
2. Ndryshimi i mandatit realizohet midis kreditorit dhe debitorit.
3. Pas pranimit nga kreditori, ai duhet të dematerializojë mandatin e ndryshuar, si dhe të arkivojë dokumentin.
4. Kreditori duhet të dërgojë informacionin e mandatit tek OSHP-ja e kreditorit si pjesë e kërkesës së ardhshme për arkëtim.

Neni 20

Anulimi i mandatit

1. Anulimi i mandatit realizohet midis kreditorit dhe debitorit pa përfshirjen e OSHP-së së kreditorit, ose OSHP-së së debitorit.
2. Dokumenti i nënshkruar i anulimit të mandatit duhet të ruhet nga kreditori të paktën sa afati i përcaktuar në nenin 1022 të Kodit Civil, në mënyrë që të kërkohet rimbursimi në rast të një transaksioni të paautorizuar.
3. Kreditori duhet të dërgojë anulimin e mandatit me kërkesën e fundit për arkëtim të iniciuar nga kreditori nën mandatin përkatës.

Neni 21

Kërkesa për arkëtim të debitimit direkt

1. Të dhënat për kërkesat për arkëtim të debitimit direkt gjenerohen nga kreditori në përputhje me Aneksin 2 (DS-03).
2. Kreditori njofton paraprakisht debitorin për vlerën dhe datën në të cilën kërkesa për arkëtim do të paraqitet në OSHP-në e debitorit për debitim. Ky njoftim duhet të dërgohet nga kreditori të paktën aq kohë përpara datës së detyrimit sa afati i përcaktuar në Aneksin 3, në parametrin “njoftimi paraprak”, përveç rasteve kur kreditori dhe debitori bien dakord për një kohëzgjatje tjetër.
3. Bazuar në informacionin e njoftimit paraprak, debitori mund të udhëzojë OSHP-në e tij të refuzojë kërkesa të ardhshme për arkëtim.
4. Kreditori dërgon të dhënat e kërkesës për arkëtim tek OSHP-së së kreditorit, përfshirë informacionin në lidhje me mandatin, në përputhje me marrëveshjen që kanë midis tyre.
5. Kreditori mund të dërgojë kërkesën për arkëtim tek OSHP-ja e kreditorit jo më herët se aq kohë përpara datës së detyrimit sa afati i përcaktuar në Aneksin 3 në

parametrin “dërgimi i kërkesës për arkëtim”, përveç rasteve kur kreditori dhe OSHP-ja e kreditorit bien dakord për një kohëzgjatje tjetër, si dhe nëse janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

- a) mandati është nënshkruar;
 - b) njoftimi paraprak është dërguar në kohë tek debitori.
6. OSHP-ja e kreditorit duhet të kontrollojë sintaksën e instruksioneve të marra dhe nëse zbulon gabime, instruksionet e përfshira do të dërgohen mbrapsht tek kreditori për korrigjim, nëpërmjet një veprimi “mospranimi” sipas Aneksit 2 (DS-05). Në këtë rast, kreditori mund të kryejë korrigjimin e nevojshëm dhe ta paraqesë instruksionin sërish, duke pasur parasysh se tipi i instruksionit të debitimit direkt (i vetëm ose përsëritës) nuk duhet të ndryshojë.
 7. Bazuar në instruksionin e marrë nga kreditori, OSHP-ja e kreditorit i dërgon kërkesën për arkëtim sistemit AECH (kur është e aplikueshme), duke u kujdesur për plotësimin e informacionit të nevojshëm në përputhje me Aneksin 2 (DS-04), duke respektuar afatet e përcaktuara nga rregullorja e sistemit AECH për paraqitjen e instruksioneve të debitimit direkt dhe të paktën aq kohë përpara datës së detyrimit sa afati i përcaktuar në Aneksin 3 në parametrin “dërgimi i kërkesës për arkëtim në AECH”, për t’i lejuar sistemit AECH të dërgojë kërkesën tek OSHP-ja e debitorit gjithashtu të paktën aq kohë përpara datës së detyrimit.
 8. Sistemi AECH kryen kontrollin e instruksionit të marrë nga OSHP-ja e kreditorit dhe, nëse zbulon gabime, instruksioni i përfshirë do t’i kthehet OSHP-së së kreditorit, nëpërmjet një veprimi “mospranimi” sipas Aneksit 2 (DS-05). Në këtë rast, instruksioni mund të paraqitet sërish pas korrigjimit, duke pasur parasysh se tipi i instruksionit të debitimit direkt (i vetëm ose përsëritës) nuk duhet të ndryshojë.
 9. Pas kontrollit dhe pranimit të instruksionit të debitimit direkt dërguar nga OSHP-ja e kreditorit, sistemi AECH dërgon instruksionin tek OSHP-ja e debitorit.
 10. Në rast se kërkesa për arkëtim nuk pranohet nga OSHP-ja e debitorit për ndonjë nga arsyet e parashikuara në këtë rregullore, OSHP-ja e debitorit dërgon veprim “mospranimi” tek sistemi AECH për instruksionin në fjalë sipas Aneksit 2 (DS-05). Në këtë rast, kreditori mund të kryejë korrigjimin e nevojshëm (aty ku aplikohet) dhe ta paraqesë instruksionin sërish, duke pasur parasysh se tipi i instruksionit të debitimit direkt (i vetëm ose përsëritës) nuk duhet të ndryshojë.
 11. Pas pranimit të instruksionit të debitimit direkt nga OSHP-ja e debitorit, ky i fundit debiton llogarinë e debitorit për vlerën në instruksion, në ditën e përcaktuar të detyrimit, dhe në përputhje me marrëveshjen me debitorin, vë në dispozicion të debitorit informacionin mbi debitimin direkt të ekzekutuar sipas Aneksit 2 (DS-06).
 12. Debitori ka të drejtë të udhëzojë OSHP-në e debitorit të rimbursojë kërkesën për arkëtim pa pasur detyrimin të japë arsyet për ngritjen e pretendimit për rimbursim. Në këtë rast:
 - a) OSHP-ja e debitorit duhet të kreditojë llogarinë e debitorit për vlerën e kërkesës për arkëtim;
 - b) OSHP-ja e debitorit i dërgon sistemit AECH (kur është e aplikueshme) instruksion për rimbursim të kërkesës për arkëtim.
 13. Nëse për ndonjë arsye llogaria e kreditorit nuk mund të debitohet, vlera e papaguar e instruksionit të “papranuar”/“kthyer”/“rimbursuar” kthehet në rrezik kredie për OSHP-në e kreditorit për t’u marrë nga kreditori, ose për t’u mbajtur si humbje nga vetë OSHP-ja e kreditorit, e cila nuk lejohet të debitojë OSHP-në e debitorit për vlerën e papaguar të instruksionit të “papranuar”/ “kthyer”/ “rimbursuar”.

Neni 22

Refuzimet, mospranimet, kthimet

- OSHP-ja e debitorit trajton refuzimet sipas kushteve të mëposhtme:
 - nëse OSHP-ja e debitorit bie dakord të trajtojë pretendimin përpara shlyerjes ndër-OSHP, veprimi i refuzimit rezulton tek OSHP-ja e debitorit si mospranim për ekzekutim i kërkesës përkatëse për arkëtim;
 - kur pretendimi trajtohet pas shlyerjes ndër-OSHP, veprimi i refuzimit trajtohet si kthim i veprimit.
- Nëse për ndonjë arsye që është e mundshme të pranohet nga të gjitha palët, OSHP-ja e debitorit nuk mund të debitojë llogarinë e debitorit, instruksioni duhet t'i kthehet sistemit AECH (kur është e aplikueshme), me arsyet për kthimin sipas Aneksit 2 (DS-05).
- Sistemi AECH dërgon tek OSHP-ja e kreditorit instruksionet e “papranuara” ose “të kthyera” sipas Aneksit 2 (DS-05). Shlyerja e tyre realizohet në sistemin AIPS, nëpërmjet debitimit të llogarisë së pjesëmarrësit shlyerës të OSHP-së së kreditorit dhe kreditimit të llogarisë së pjesëmarrësit shlyerës të OSHP-së së debitorit.
- Shlyerja e kthimeve mund të realizohet deri në aq kohë pas datës së detyrimit, sa afati i përcaktuar në Aneksin 3 në parametrin “shlyerja e kthimeve”.
- Në rastin e instruksioneve të “papranuara” ose “të kthyera”, OSHP-ja e kreditorit debiton llogarinë e kreditorit për vlerën e instruksioneve të “papranuara” ose “të kthyera”, vetëm nëse llogaria e kreditorit ka qenë kredituar më parë për këtë instruksion.

Neni 23

Kërkesa për rimbursim e transaksioneve të paautorizuara

- Debitori mund të iniciojë një kërkesë për rimbursim, në rast të një transaksioni të paautorizuar. Kjo kërkesë iniciohet nga debitori drejt OSHP-së së debitorit, pas përfundimit të afatit për rimbursimin pa arsyetim, përcaktuar në Aneksin 3 në parametrin “afati për rimbursim pa arsyetim”, por jo më vonë se afati ligjor i referuar në Aneksin 3 në parametrin “afati për rimbursim veprimi të paautorizuar”. Në lidhje me këtë:
 - debitori mund të kërkojë rimbursim të një kërkesë për arkëtim, të cilën e konsideron të paautorizuar prej tij;
 - debitori duhet t'i dërgojë pretendimin OSHP-së së debitorit, së bashku me dëshmitë mbështetëse, nëse ka të tilla;
 - udhëzimet që i jepen debitorit nga OSHP-ja e debitorit, në këtë rast, nuk janë objekt rregullimi të kësaj rregulloreje;
 - në rastin e një pretendimi për rimbursim të një debitimi direkt të paautorizuar brenda afatit për rimbursim pa arsyetim nga data e debitimit, OSHP-ja e debitorit mund të kërkojë një kopje të mandatit të plotësuar sipas Aneksit 2 (DS-10).
- Në rastin e një kërkesë për rimbursim për një transaksion të paautorizuar, OSHP-ja e debitorit kontrollon kërkesën e mbërritur dhe mund të vendosë ta pranojë ose jo atë. Për të vendosur për pranimin ose jo të kërkesës, ndiqen kriteret e mëposhtme dhe nëse ndonjëri prej tyre nuk përmbushet, atëherë pretendimi duhet të pranohet.
 - Mandati i dakorduar nga debitori, si dhe ndryshimet e tij, duhet të përputhen me të dhënat e mandatit të ofruara nga kreditori si pjesë e kërkesës për arkëtim, apo të dërguara nga kreditori si një kopje e mandatit.
 - Mandati nuk duhet të jetë anuluar nga debitori ose nga kreditori në momentin e debitimit për kërkesën në diskutim.

- c) Kur mandati është ndryshuar nga një prej palëve, atributet e ndryshuara të tij duhet të jenë marrë parasysh.
 - d) Mandati nuk duhet të ketë kaluar afatin maksimal të periudhës së inaktivitetit të përcaktuar në Aneksin 3 në parametrin “periudha e inaktivitetit” që prej datës së fundit të përdorimit të tij, gjë që do të rezultonte në anulimin automatik të tij, dhe që duhet të respektohet nga kreditori.
3. Nëse OSHP-ja e debitorit e pranon kërkesën për rimbursim, atëherë duhet të përcjellë pretendimin (pa dëshmi mbështetëse) tek OSHP-ja e kreditorit, e cila duhet ta përcjellë më tej tek kreditori. Përcjellja e pretendimit tek OSHP-ja e kreditorit kryhet sipas Aneksit 2 (DS-08), dhe brenda afatit të përcaktuar në Aneksin 3, në parametrin “përcjellja e pretendimit për rimbursim tek OSHP-ja e kreditorit” si kohë pas marrjes së kërkesës nga OSHP-ja e debitorit.
 4. OSHP-ja e kreditorit përcjell kërkesën për rimbursim tek kreditori sipas një formati të dakordësuar me marrëveshje midis tyre, dhe brenda afatit të përcaktuar në Aneksin 3, në parametrin “përcjellja e pretendimit për rimbursim tek kreditori” si kohë pas marrjes së kërkesës prej tij.
 5. Kreditori shqyrton kërkesën për rimbursim dhe i kthen përgjigje OSHP-së së kreditorit sipas, veprimet që ndërmerr si më poshtë:
 - a) pranon pretendimin për rimbursim të debitorit (për të gjithë tipat e kërkesave për rimbursim). Sipas rastit për tipin 1 të kërkesës për rimbursim, kreditori nuk duhet të dërgojë kopje të mandatit, kurse për tipin 2 kreditori duhet gjithmonë të përcjellë kopje të mandatit;
 - b) konteston pretendimin e debitorit dhe në këtë rast, duhet të dërgojë kopje të mandatit (për tipat 1 dhe 2 të kërkesës për rimbursim);
 - c) konteston pretendimin e debitorit (për tipat 3 dhe 4 të kërkesës për rimbursim), e në këtë rast kreditori duhet të sigurojë informacion mbështetës.
 6. Përgjigja që kreditori i dërgon OSHP-së së kreditorit duhet të përmbajë informacion të mjaftueshëm për t’i dhënë mundësi OSHP-së së kreditorit të ndërtojë instruksionin që duhet t’i përcjellë OSHP-së së debitorit brenda afatit të përcaktuar në Aneksin 3, në parametrin “përgjigja e kreditorit për pretendimin për rimbursim” si kohë pas marrjes së kërkesës nga kreditori.
 7. OSHP-ja e kreditorit duhet të përcjellë përgjigjen e marrë nga kreditori tek OSHP-ja e debitorit, sipas mënyrës së rënë dakord me OSHP-në e debitorit.
 8. Pasi OSHP-ja e debitorit merr përgjigje prej OSHP-së së kreditorit, ose pas afatit të përcaktuar në Aneksin 3, në parametrin “afati për pritjen e përgjigjes”, duke llogaritur nga data kur OSHP-ja e debitorit ka marrë pretendimin prej debitorit, OSHP-ja e debitorit duhet të marrë vendimin për pretendimin për rimbursim, duke konsideruar rastet e mëposhtme:
 - a) OSHP-ja e debitorit mund të pranojë pretendimin për rimbursim kur kreditori pranon pretendimin (tipat e përgjigjeve 1 dhe 2 të dhëna nga kreditori);
 - b) OSHP-ja e debitorit mund të pranojë pretendimin e debitorit pas krahasimit të pretendimit të debitorit me kopjen e mandatit dhe informacionin mbështetës të marrë nga OSHP-ja e kreditorit dhe kreditori;
 - c) OSHP-ja e debitorit mund të mos pranojë pretendimin e debitorit;
 - d) nëse OSHP-ja e debitorit nuk merr përgjigje nga OSHP-ja e kreditorit brenda afatit të përcaktuar në Aneksin 3, në parametrin “afati për pritjen e përgjigjes”, duke llogaritur nga data kur OSHP-ja e debitorit ka marrë pretendimin prej debitorit, atëherë OSHP-ja e debitorit mund të vendosë për

pretendimin dhe të vijojë në mënyrën që e konsideron më të përshtatshme, duke marrë parasysh dëshmitë e paraqitura nga debitori.

Neni 24

Vendimi për rimbursim të transaksioneve të paautorizuara

1. Vendimi i marrë nga OSHP-ja e debitorit për pretendimin për rimbursim është final për palët dhe konsiderohet si hapi i fundit i këtij procesi.
2. Ky vendim duhet të ekzekutohet brenda afatit të përcaktuar në Aneksin 3, në parametrin “afati për vendimin për rimbursim”, duke filluar nga data e marrjes së përgjigjes nga OSHP-ja e debitorit.
3. Nëse OSHP-ja e debitorit vendos për rimbursimin e debitorit, atëherë OSHP-ja e debitorit:
 - a) krediton llogarinë e debitorit për vlerën e kërkesës për arkëtim të pretenduar dhe informon debitorin;
 - b) dërgon në sistemin AECH një instruksion për rimbursim të transaksionit të paautorizuar sipas Aneksit 2 (DS-05);
 - c) aplikon një vlerë kompensimi në favor të llogarisë së debitorit për një periudhë që përfshin kohën midis ditës së debitimit origjinal dhe ditës së ekzekutimit të pagesës së rimbursimit në llogarinë e debitorit;
 - d) mund të marrë nga OSHP-ja e kreditorit vlerën e rimbursimit;
 - e) mund të marrë gjithashtu nga OSHP-ja e kreditorit kompensimin për rimbursimin, duke zbatuar të njëjtat rregulla si për rimbursimin, duke respektuar afatet si në Aneksin 3, në parametrin “afati për kompensimin për rimbursim”.
4. Nëse OSHP-ja e debitorit vendos të mos pranojë dhe të mos ekzekutojë pretendimin për rimbursim, atëherë debitori duhet të informohet pa vonesa, dhe dëshmitë mbështetëse të marra nga kreditori duhet t’i vihen në dispozicion debitorit.
5. Kreditori dhe debitori mund të përdorin të gjitha mënyrat e mundshme për të rihapur diskutimin e pretendimit, por ky rast nuk është objekt rregullimi i kësaj rregulloreje.

Neni 25

Rimbursimi

1. Pas rimbursimit të debitorit, OSHP-ja e debitorit është e autorizuar nga kjo rregullore që lidhur me këtë proces të marrë rimbursim nga OSHP-ja e kreditorit. Ky rimbursim nuk e përjashton debitorin nga përgjegjësitë e tij për të kërkuar zgjidhje të mosmarrëveshjeve me kreditorin, dhe as pagesa e rimbursimit nuk paragjykon rezultatin e asaj zgjidhjeje.
2. OSHP-ja e debitorit ka të drejtë të marrë kompensim, të quajtur kompensim i rimbursimit, nga OSHP-ja e kreditorit, për humbjen e interesit përkatës të shkaktuar OSHP-së së debitorit prej kreditimit të llogarisë së debitorit në datën e debitimit të kërkesës fillestare për arkëtim. Vlera e kompensimit specifikohet në të dhënat e instruksionit të plotësuar sipas Aneksit 2 (DS-05).
3. Përlllogaritja e interesit për kompensimin nga OSHP-ja e debitorit kryhet me normën e *repo* 1-javore + 2 pikë përqindje për çdo ditë nga data e shlyerjes së kërkesës fillestare, deri në datën e shlyerjes së instruksionit të rimbursimit të paraqitur në sistemin AECH nga OSHP-ja e debitorit (pa përfshirë ditën e shlyerjes së rimbursimit).
4. Me marrjen e një instruksioni për rimbursim nga OSHP-ja e debitorit, sistemi AECH i dërgon OSHP-së së kreditorit instruksionin për rimbursim të transaksionit. Shlyerja realizohet në sistemin AIPS nëpërmjet debitimit të llogarisë së

pjesëmarrësit shlyerës të OSHP-së së kreditorit dhe kreditimit të llogarisë së pjesëmarrësit shlyerës të OSHP-së së debitorit për vlerën fillestare të kërkesës për arkëtim dhe për vlerën e kompensimit të rimbursimit të përlogaritur nga OSHP-ja e debitorit.

5. OSHP-ja e kreditorit duhet të debitojë llogarinë e kreditorit për vlerën e instruksioneve të mara për rimbursim. Për marrjen e kompensimit të rimbursimit, OSHP-ja e kreditorit mund të vendosë marrëveshje të tij me kreditorin, në lidhje me termat e kompensimit dhe datën përkatëse, e cila nuk përcaktohet nga kjo rregullore. Kjo do të thotë se një kreditor mund të jetë i detyruar nga OSHP-ja e kreditorit, bazuar në një marrëveshje të tillë, të mbajë llogarinë e tij pranë OSHP-së së kreditorit, pas përfundimit të marrëdhënies lidhur me debitimin direkt, për një periudhë të caktuar, në mënyrë që të mundësojë këto transaksione rimbursimi.
6. Në rast se kreditori nuk bie dakord me rimbursimin, ai duhet të kontaktojë me debitorin dhe të zgjidhin pretendimet përtej kësaj rregulloreje.
7. Afati për rimbursimin e pretendimeve pa arsyetim është deri në atë kohë nga data e debitimit sa afati i përcaktuar në Aneksin 3, në parametrin “afati për rimbursim pa arsyetim”.
8. Afati për marrjen e kompensimit për rimbursimin e pretendimeve pa arsyetim është deri atë kohë pas datës së debitimit sa afati i përcaktuar në Aneksin 3, në parametrin “afati për kompensimin për rimbursim”.

Neni 26

Pagesa për veprim me kah të kundërt

1. Veprimet me kah të kundërt me një debitim direkt, iniciohen nga kreditori pas shlyerjes së instruksionit të debitimit direkt, kur kreditori kupton se instruksioni nuk duhet të ishte paraqitur për arsye dyfishimi apo arsye të paspecifikuar.
2. Veprimi me kah të kundërt duhet të përmbajë referencën e kërkesës fillestare për arkëtim, në mënyrë që debitorin të kryejë rakordimin midis veprimit origjinal dhe atij me kah të kundërt.
3. OSHP-ja e kreditorit përcjell instruksionin e veprimit me kah të kundërt tek sistemi AECH, duke u kujdesur për përmbajtjen e informacionit, siç përcaktohet në Aneksin 2 (DS-07), si dhe debiton llogarinë e kreditorit.
4. OSHP-ja e kreditorit duhet të tregojë kujdes në monitorimin e përdorimit të instruksioneve të veprimeve me kah të kundërt nga kreditorët, për të përjashtuar abuzimet, duke qenë se bëhet fjalë për transaksione që shmangen nga rregulli i përgjithshëm i ekzekutimit të tyre.
5. Pas procesimit nga sistemi AECH, duke përcjellë instruksionin e veprimit me kah të kundërt tek OSHP-ja e debitorit, realizohet shlyerja në sistemin AIPS nëpërmjet debitimit të llogarisë së pjesëmarrësit shlyerës të OSHP-së së kreditorit dhe kreditimit të llogarisë së pjesëmarrësit shlyerës të OSHP-së së debitorit.
6. Në vijim të procesit të klerimit dhe shlyerjes, OSHP-ja e debitorit krediton llogarinë e debitorit dhe i dërgon informacion mbi veprimin e kryer debitorit, sipas përcaktimeve në Aneksin 2 (DS-06).
7. OSHP-ja e debitorit nuk ka detyrim të kontrollojë nëse instruksioni origjinal i debitimit direkt ka kryer debitimin e llogarisë së debitorit apo nuk është pranuar, kthyer ose rimbursuar.
8. Afati për shlyerjen e pagesës sipas veprimit me kah të kundërt është deri në atë kohë nga data e shlyerjes së transaksionit të debitimit direkt sa afati i përcaktuar në Aneksin 3 në parametrin “pagesa për veprim me kah të kundërt”.

9. Në lidhje me afatin e finalizimit të kreditimit në llogarinë e debitorit, kjo është në varësi të marrëdhënies midis debitorit dhe OSHP-së së debitorit.

Neni 27

Dërgimi i kopjes së mandatit

1. OSHP-ja e debitorit i dërgon kërkesë OSHP-së së kreditorit për të marrë një kopje të mandatit dhe të ndryshimeve përkatëse.
2. Kërkesa e dërguar nga OSHP-ja e debitorit tek OSHP-ja e kreditorit duhet të plotësohet me informacionin e nevojshëm, siç përcaktohet në Aneksin 2 (DS-10).
3. OSHP-ja e kreditorit përcjell kërkesën e marrë për kopje të mandatit tek kreditori, brenda aq kohe nga data e marrjes së kërkesës sa afati i përcaktuar në Aneksin 3, në parametrin “përcjellje e kërkesës për kopje mandati”. Kjo kërkesë përcillet në një format të dakordësuar midis kreditorit dhe OSHP-së së kreditorit.
4. Kreditori siguron një kopje të mandatit dhe ia dërgon atë OSHP-së së kreditorit, ose shpjegon arsyet nëse nuk mund ta sigurojë një kopje të mandatit, brenda aq kohe nga data e marrjes së kërkesës sa afati i përcaktuar në Aneksin 3, në parametrin “përcjellje kopje mandati”. Dërgimi i përgjigjes nga kreditori tek OSHP-ja e kreditorit realizohet nëpërmjet një kanali komunikimit të sigurt të pranuar midis OSHP-së së kreditorit dhe kreditorit.
5. OSHP-ja e kreditorit duhet të përcjellë përgjigjen e marrë nga kreditori (kopjen e mandatit ose arsyet për mosdërgim) tek OSHP-ja e debitorit, nëpërmjet kanalit të komunikimit të përcaktuar nga OSHP-ja e debitorit në kërkesë.

KREU IV

KLERIMI DHE SHLYERJA

Neni 28

Roli i sistemit AECH

1. Sistemi AECH ofron për pjesëmarrësit e tij shërbimin e klerimit të instruksioneve të debitimit direkt.
2. Në kuadër të trajtimit të proceseve të lidhura me debitimin direkt, sistemi AECH:
 - a) merr nga pjesëmarrës OSHP të kreditorëve (ose OSHP ndërmjetësuese përkatëse) instruksione debitimi direkt për klerim;
 - b) klonon dhe përcjell ato instruksione tek pjesëmarrësit përkatës OSHP të debitorëve (ose OSHP ndërmjetësuese përkatëse), duke siguruar se i gjithë informacioni i dërguar nga kreditori dhe OSHP-ja e tij me destinacion OSHP-në e debitorit dhe debitorin, përcillet nga sistemi i plotë dhe i pacenuar;
 - c) trajton transaksionet që shmangen nga rregulli i përgjithshëm i ekzekutimit të tyre, e që rezultojnë në raste përjashtuese;
 - d) dërgon për shlyerje në sistemin AIPS rezultatin e klerimit të instruksioneve të debitimit direkt;
 - e) pranon dhe përpunon transaksione të debitimit direkt në përputhje me afatet, si dhe formatet dhe kërkesat teknike të sistemit AECH, sipas përcaktimeve në rregulloren e sistemit AECH dhe manualet e përdorimit të tij.

Neni 29

Shlyerja e transaksioneve të debitimit direkt

1. Shlyerja e pozicioneve neto të krijuara nga shkëmbimi i instruksioneve të debitimit direkt të dërguara nga pjesëmarrësit në sistemin AECH, kryhet në datën e detyrimit

që përmbajnë instruksionet e debitimit direkt të dërguara, me përjashtim të datave të trajtuara si raste të veçanta.

2. Shlyerja realizohet në sistemin AIPS në llogaritë e shlyerjes së pjesëmarrësve shlyerës të pjesëmarrësve të sistemit AECH të përfshirë në instruksionin e debitimit direkt.
3. Shlyerja bazohet në rregullat e funksionimit të sistemit AECH për dërgimin e rezultatit të klerimit për shlyerje në AIPS, si dhe në rregullat përkatëse të funksionimit të sistemit AIPS.

Neni 30

Mjaftueshmëria e fondeve në llogari

1. Debitori, pasi merr njoftimin paraprak nga kreditori në lidhje me vlerën dhe datën e debitimit, duhet të sigurohet se në atë datë gjendja e llogarisë së tij me OSHP-në e debitorit, e cila do të debitohet, është e mjaftueshme për të mbuluar vlerën e përcaktuar në kërkesën për arkëtim.
2. OSHP-ja e debitorit duhet të sigurojë me pjesëmarrësin shlyerës përkatës në AIPS, se gjendja e llogarisë së pjesëmarrësit shlyerës të tij në sistemin AIPS, nga e cila do të paguhet kërkesa për arkëtim, është e mjaftueshme për të mbuluar vlerën e kërkesës për arkëtim në datën e shlyerjes.

Neni 31

Tarifat dhe komisionet

1. Komisionet e aplikuara ndaj PSHP-së për debitimin direkt do të bazohen në parimin e ndarjes, në mënyrë që kreditori dhe debitori të ngarkohen veçmas dhe individualisht, përkatësisht nga OSHP-ja e kreditorit dhe nga OSHP-ja e debitorit.
2. Për transaksione të tipit “R”, OSHP-ja e debitorit dhe OSHP-ja e kreditorit mund të vendosin tarifa shkëmbimi, dhe përkatësisht të ngarkojnë me komisione debitorin apo kreditorin, sipas rastit, kur ai është shkaktari i transaksionit të tipit “R”.
3. Nuk duhet të aplikohen tarifa shumëpalëshe shkëmbimi për transaksion debitimi direkt, ose ndonjë remunerim tjetër i rënë dakord me objekt ose efekt të njëvlershëm mbi transaksionet e debitimit direkt.
4. Për transaksione të tipit “R”, mund të aplikohet tarifë shumëpalëshe shkëmbimi vetëm në rast se përmbushen kushtet e mëposhtme:
 - a) marrëveshja për tarifa shumëpalëshe shkëmbimi synon ngarkimin efektiv të kostove tek OSHP/PSHP-ja, e cila ka shkaktuar transaksionin “R” sipas rastit, duke marrë parasysh ekzistencën e kostove të transaksioneve, dhe siguron që paguesi nuk ngarkohet automatikisht me tarifa, si dhe OSHP-ja ndalohet të ngarkojë PSHP-të me tarifa në lidhje me një tip të caktuar komisioni/tarife për transaksione “R”, që tejkalon kostot e lindura nga OSHP-ja për të tilla transaksione;
 - b) këto tarifa bazohen ngushtësisht në kosto;
 - c) niveli i tarifave nuk e tejkalon koston aktuale të përpunimit të një transaksioni “R” nga OSHP-ja më efektiv në pikëpamjen krahasuese të kostove, e cila është palë përfaqësuese në marrëveshje në terma të vëllimit të transaksioneve dhe natyrës së shërbimeve;
 - d) aplikimi i tarifave në përputhje me shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike, e pengon OSHP-në t’u vendosë PSHP-ve përkatëse tarifa shtesë në lidhje me kosto të mbuluara nga ato tarifa shkëmbimi;
 - e) nuk ka alternativa praktike dhe ekonomikisht të zbatueshme për marrëveshjen që mund të çojnë në një mënyrë po aq ose më efektive të

trajtimit të transaksioneve “R”, me një kosto të njëjtë, ose më të ulët për konsumatorin.

Për qëllime të shkronjës “a” të kësaj pike, vetëm kategoritë e kostove të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pagabueshme me trajtimin e transaksioneve “R” do të merren parasysh në llogaritjen e tarifave të transaksioneve “R”. Këto kosto do të përcaktohen saktësisht. Ndarja e vlerës së kostove, duke përfshirë identifikimin e veçantë të secilit prej përbërësve të saj, do të jetë pjesë e marrëveshjes për të mundësuar verifikimin dhe monitorimin me lehtësi.

5. Përcaktimet në lidhje me tarifën shumëpalëshe të shkëmbimit në këtë nen, duhet të aplikohen në të njëjtën mënyrë edhe për marrëveshje të njëanshme të një OSHP-je dhe për marrëveshje dypalëshe midis OSHP-ve, të cilat kanë objekt ose efekt të njëvlershëm me atë të një marrëveshjeje shumëpalëshe.
6. Baza dhe niveli i komisioneve për klientët janë tërësisht çështje të OSHP-ve individuale dhe klientëve të tyre, megjithatë komisionet e aplikuar nga OSHP-të në lidhje me shërbime të debitimit direkt që ofrojnë ndaj debitorëve, kreditorëve apo ndaj OSHP-ve të tjera në rolin e ndërmjetësuesit, duhet të jenë transparente, të shprehura qartë dhe të bazuara në kosto.

Neni 32

Historiku i auditimit

1. Kreditori krijon dhe mban dosjen e historikut të auditimit për çdo kërkesë për arkëtim.
2. Dosja e historikut të auditimit duhet të përmbajë mandatin, kopje të njoftimeve paraprake të bëra në lidhje me kërkesën për arkëtim, si dhe çdo informacion tjetër të domosdoshëm për të identifikuar apo audituar një kërkesë për arkëtim.
3. Dosja e historikut të auditimit për çdo kërkesë për arkëtim mbahet për një periudhë minimale kohe prej 36 muajsh.
4. Secila nga palët e përfshira në një debitim direkt duhet të ruajë informacionin dhe dokumentacionin e plotë mbi kërkesat për arkëtim dhe veprimet e kryera për to, të paktën për aq kohë sa mandati i lidhur me ato kërkesa për arkëtim të jetë ende i vlefshëm, si dhe për të paktën aq kohë sa parashikohet në afatin maksimal për rimbursimin e një transaksioni të paautorizuar.
5. Kërkesat e mësipërme për të krijuar dhe mbajtur historikun e auditimit, si dhe kërkesat për ruajtjen e dokumentacionit dhe regjistrimeve në lidhje me debitimin direkt, janë të zbatueshme vetëm për qëllim të kësaj rregulloreje dhe nuk i përjashtojnë palët e përfshira nga detyrimi për të zbatuar dispozitat e tjera ligjore, subjekte të të cilave ato janë, në lidhje me krijimin dhe mbajtjen e informacionit për qëllime auditimi apo për qëllime të tjera.

KREU V TË FUNDIT

Neni 33

Paraqitja e pretendimit për rimbursim pas skadimit të afateve kohore

Nëse një debitor bën një kërkesë për rimbursim pasi kanë skaduar afatet kohore të parashikuara nga kjo rregullore dhe paraqitura në Aneksin 3, kjo kërkesë shqyrtohet nga palët jashtë sistemit AECH, dhe transaksioni në fjalë i debitimit direkt nuk ekzekutohet nëpërmjet sistemit AECH.

Neni 34

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis ofruesve të shërbimeve të pagesave (OSHP) dhe përdoruesve të shërbimeve të pagesave (PSHP), zbatohen dispozitat e ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 35

Dispozitë kalimtare

Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, subjektet mbi të cilat zbatohen dispozitat e saj kanë afat deri në fund të vitit 2022 për rishikimin e mandateve ekzistuese, që ato subjekte kanë në përdorim, dhe kushteve përkatëse të përcaktuara në marrëdhëniet midis palëve në funksion të transaksioneve të debitimit direkt për të cilat janë autorizuar përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, së bashku me plotësimin e informacionit për ID-të e kreditorit.

Neni 36

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 30 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Gent SEJKO

Aneks 1 – Lista e attributeve

<i>Kodi i atributit</i>	<i>Përshkrimi</i>
AT-01	Referenca unike e mandatit
AT-02	ID-ja e kreditorit
AT-03	Emri i kreditorit
AT-04	Numri i llogarisë IBAN i kreditorit
AT-05	Adresa e kreditorit
AT-06	Vlera e kërkesës për arkëtim
AT-07	Numri i llogarisë IBAN i debitorit
AT-08	Numri identifikues i kontratës
AT-09	Adresa e debitorit
AT-10	Referenca e kreditorit për transaksionin e debitimit direkt
AT-11	Data e detyrimit të kërkesës për arkëtim
AT-12	Kodi BIC i OSHP-së së kreditorit
AT-13	Kodi BIC i OSHP-së së debitorit
AT-14	Emri i debitorit
AT-15	Emri i palës referencë për debitorin
AT-16	Hapësira për të dhënat e nënshkrimit elektronik
AT-17	Tipi i mandatit (letër, elektronik)
AT-18	ID-ja e kreditorit të origjinës që ka lëshuar mandatin (përpara se mandati dhe kontrata përkatëse të merrej nga një kreditor tjetër)
AT-19	Referenca unike e mandatit e dhënë nga kreditori i origjinës që ka lëshuar mandatin (përpara se mandati dhe kontrata përkatëse të merrej nga një kreditor tjetër)
AT-20	Kodi identifikues i skemës DD në Shqipëri
AT-21	Tipi i transaksionit (1 - i vetëm, 2- përsëritës/rekurent jo i fundit i grupit 3- i pari në një grup transaksionesh përsëritës/rekurent 4- i fundit në një grup transaksionesh përsëritës/rekurent 5- veprim me kah të kundërt)
AT-22	Informacion i dhënë nga kreditori në kërkesën për arkëtim të debitimit direkt dhe dërguar debitorit për lehtësi të rakordimit të pagesave
AT-24	Arsyeja për ndryshimin e mandatit

AT-25	Data e nënshkrimit të mandatit
AT-26	Data e shlyerjes së kërkesës për arkëtim
AT-27	Kodi i identifikimit të debitorit
AT-31	Kodi i arsyes së veprimit me kah të kundërt të kërkesës për arkëtim (dublikim, arsye e pa specifikuar)
AT-33	Nënshkrim(et) në letër të debitor(ëve)
AT-36	Data e nënshkrimit të anulimit të mandatit
AT-37	Kodi i identifikimit i palës referencë për debitorin
AT-38	Emri i palës referencë për kreditorin
AT-39	Kodi i identifikimit i palës referencë për kreditorin
AT-43	Referenca e OSHP-së së kreditorit për kërkesën për arkëtim
AT-44	Vlera e veprimit me kah të kundërt të kërkesës për arkëtim (nuk lejohen kthime të pjesshme)
AT-45	Referenca e OSHP-së së debitorit për një kërkesë (për rimbursim të një transaksioni të paautorizuar, ose për të marrë një kopje të mandatit)
AT-46	Kodi i tipit të kërkesës për rimbursim (për rimbursimin e një transaksioni të paautorizuar. Katër tipa kërkesash: 1- një kopje e mandatit kërkohet nga OSHP-ja e debitorit – kopja duhet të jepet, përveç rastit kur kreditori pranon pretendimin; 2- një kopje e mandatit kërkohet nga OSHP-ja e debitorit – kopja duhet të jepet edhe nëse kreditori pranon pretendimin; 3- nuk kërkohet kopje e mandatit nga OSHP-ja e debitorit, duke qenë se sipas debitorit mandati është anuluar prej tij; 4- nuk kërkohet kopje e mandatit nga OSHP-ja e debitorit, duke qenë se mandati duhet të jetë anuluar nga kreditori pasi nuk ka qenë aktiv për 36 muaj pas kërkesës së fundit për arkëtim.
AT-47	Data e marrjes së kërkesës nga OSHP-ja e debitorit (data kur kërkesa e iniciuar nga debitorit është marrë nga OSHP-ja e debitorit)
AT-48	Data e dërgimit të kërkesës nga OSHP-ja e debitorit (data kur kërkesa është dërguar nga OSHP-ja e debitorit për tek OSHP-ja e kreditorit)
AT-49	Emri i OSHP-së së debitorit
AT-50	Detajet e kontaktit të OSHP-së së debitorit
AT-51	Adresa email ose numri i faksit të OSHP-së së debitorit ku kopja e mandatit duhet të dërgohet nga OSHP-ja e kreditorit.
AT-52	Treguesi nëse kërkohet konfirmim i marrjes së kërkesës nga OSHP-a e kreditorit (po/jo)

AT-53	Data e debitimit të kërkesës për arkëtim
AT-54	Data më e fundit e kërkesës për arkëtim
AT-55	Data e anulimit
AT-56	Referenca e përgjigjes së kreditorit (mbi kërkesën e OSHP-së së debitorit)
AT-57	Kodet e tipeve të përgjigjes (dhënë OSHP-ja e debitorit nga OSHP-ja e kreditorit: 1- kreditori pranon pretendimin për rimbursim paraqitur nga debitori (e aplikueshme për kërkesë për rimbursim); 2- kreditori siguron kopje të mandatit (e aplikueshme për kërkesë për rimbursim); 3- pretendim i diskutueshëm nga kreditori (e aplikueshme për kërkesë për rimbursim); 4- kreditori siguron kopje të mandatit (e aplikueshme për kërkesë për kopje mandati); 5- kreditori nuk siguron kopje të mandatit (e aplikueshme për kërkesë për kopje mandati)
AT-58	Qëllimi i kërkesës për arkëtim
AT-59	Kategoria e qëllimit të kërkesës për arkëtim
AT-R1	Tipi i mesazhit “R” (përmban kodin e identifikimit të një nga mesazheve: Reject (mospranim), Return (kthim), Refund (rimbursim))
AT-R2	Identifikimi i tipit të palës që inicion mesazhin “R” (OSHP-ja e kreditorit (për Reject, Reverse), OSHP-ja e debitorit (për Reject, Return), operatori (vetëm Reject), kreditori (vetëm Reverse), debitori (vetëm Refund))
AT-R3	Kodi i arsyes për mospranim të kërkesës për arkëtim (Reject/Return/Refund)
AT-R4	Data e shlyerjes e kthimit, rimbursimit, ose veprimit me kah të kundërt
AT-R5	Referencë e posaçme e OSHP-së që inicion Reject/Return/Refund për atë Reject/Return/Refund
AT-R6	Kompensimi i rimbursimit që pranon OSHP-ja e debitorit nga OSHP-ja e kreditorit
AT-R7	Referencë e posaçme e OSHP-së së kreditorit për veprimin me kah të kundërt (Reverse)
AT-R8	Vlera e tarifës së shkëmbimit

Aneks 2 – Koleksioni i të dhënave dhe atributet e shkëmbyera midis palëve që ndërveprojnë në transaksionet e debitimit direkt

DS-01: Mandati

Mandati mund të paraqitet në një format të përshtatshëm të personalizuar nga vetë kreditori, por që duhet të jetë i qartë e i kuptueshme për përdoruesit e tij, si dhe të përmbajë informacionin e nevojshëm të listuar më poshtë në trajtën e koleksionit të të dhënave, të cilat janë një nënbashkësi e nevojshme prej attributeve të paraqitura në Aneksin 1. Për secilin atribut përcaktohet edhe pala përgjegjëse për plotësimin e informacionit.

<i>Kodi i atributit</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Plotësohet nga</i>
AT-01	Referenca unike e mandatit	kreditori
AT-14	Emri i debitorit	debitori
AT-09	Adresa e debitorit (përfshirë kodin postar, qyteti, shteti i rezidencës)	debitori
AT-27	Kodi i identifikimit të debitorit (jo i detyrueshëm)	debitori
AT-07	Numri i llogarisë IBAN i debitorit	debitori
AT-08	Numri identifikues i kontratës (jo i detyrueshëm)	kreditori
AT-13	Kodi BIC i OSHP-së së debitorit	debitori
AT-02	ID-ja e kreditorit	kreditori
AT-03	Emri i kreditorit	kreditori
AT-05	Adresa e kreditorit (përfshirë kodin postar, qyteti, shteti i rezidencës)	kreditori
AT-21	Tipi i transaksionit (1 - i vetëm, 2- përsëritës/rekurent)	kreditori
AT-25	Data e nënshkrimit të mandatit	debitori
AT-33	Nënshkrim(et) në letër të debitor(ëve)	debitori
AT-16	Hapësira për të dhënat e nënshkrimit elektronik	debitori
AT-15	Emri i palës referencë për debitorin (Jo i detyrueshëm)	debitori
AT-37	Kodi i identifikimit i palës referencë për debitorin (jo i detyrueshëm)	debitori
AT-38	Emri i palës referencë për kreditorin (jo i detyrueshëm)	kreditori

AT-39	Kodi i identifikimit i palës referencë për kreditorin (jo i detyrueshëm)	kreditori
-------	---	-----------

DS-02: Mandati i dematerializuar

Informacioni i marrë nëpërmjet mandatit konvertohet në të dhëna elektronike, të cilat regjistrohen dhe ruhen nga kreditori për qëllime të ekzekutimit të instruksioneve të debitimit direkt. Koleksioni i të dhënave që përbëjnë mandatin e dematerializuar përbëhet nga attribute prej listës së paraqitur në Aneksin 1, ndër të cilat duhet që të përfshihen të gjitha atributet e detyrueshme që merren nga mandati. Atributet janë të detyrueshme përveç nëse përcaktohet ndryshe.

<i>Kodi i atributit</i>	<i>Përshkrimi</i>
AT-01	Referenca unike e mandatit
AT-14	Emri i debitorit
AT-09	Adresa e debitorit (nëse është dhënë në DS-01)
AT-27	Kodi i identifikimit të debitorit (nëse është dhënë në DS-01)
AT-07	Numri i llogarisë IBAN i debitorit
AT-08	Numri identifikues i kontratës (nëse është dhënë në DS-01)
AT-13	Kodi BIC i OSHP-së së debitorit (nëse është dhënë në DS-01)
AT-02	ID-ja e kreditorit
AT-03	Emri i kreditorit
AT-05	Adresa e kreditorit
AT-21	Tipi i transaksionit (1 - i vetëm, 2- përsëritës/rekurent)
AT-25	Data e nënshkrimit të mandatit
AT-33	Nënshkrim(et) në letër të debitor(ëve)
AT-16	Hapësira për të dhënat e nënshkrimit elektronik
AT-24	Arsyeja për ndryshimin e mandatit (e detyrueshme për ndryshimet)
AT-36	Data e nënshkrimit të anulimit të mandatit
AT-15	Emri i palës referencë për debitorin (nëse është dhënë në DS-01)
AT-37	Kodi i identifikimit i palës referencë për debitorin (nëse është dhënë në DS-01)

AT-38	Emri i palës referencë për kreditorin (nëse është dhënë në DS-01)
AT-39	Kodi i identifikimit i palës referencë për kreditorin (nëse është dhënë në DS-01)

DS-03: Kërkesë për arkëtim nga kreditori tek OSHP-ja e kreditorit

Kreditori duhet të plotësojë kërkesën për arkëtim, që do të dërgohet drejt OSHP-së së kreditorit, me koleksionin e të dhënave të nevojshme, i cili përbëhet nga atributet e mëposhtme pjesë e listës së attributeve të paraqitura në Aneksin 1. Atributet janë të detyrueshme përveç nëse përcaktohet ndryshe.

<i>Kodi i atributit</i>	<i>Përshkrimi</i>
AT-20	Kodi identifikues i skemës DD në Shqipëri
AT-21	Tipi i transaksionit (1 - i vetëm, 2- përsëritës/rekurent jo i fundit i grupit, 3- i pari në një grup transaksionesh përsëritës/rekurent, 4- i fundit në një grup transaksionesh përsëritës/rekurent, 5- veprim me kah të kundërt)
AT-10	Referenca e kreditorit për transaksionin e debitimit direkt
AT-03	Emri i kreditorit
AT-05	Adresa e kreditorit (jo e detyrueshme)
AT-02	ID-ja e kreditorit
AT-38	Emri i palës referencë për kreditorin (nëse është prezent në DS-02)
AT-39	Kodi i identifikimit i palës referencë për kreditorin (nëse është prezent në DS-02)
AT-04	Numri i llogarisë IBAN i kreditorit
AT-12	Kodi BIC i OSHP-së së kreditorit
AT-14	Emri i debitorit
AT-09	Adresa e debitorit (jo e detyrueshme)
AT-27	Kodi i identifikimit të debitorit (jo e detyrueshme)
AT-15	Emri i palës referencë për debitorin (nëse është prezent në DS-02)

AT-37	Kodi i identifikimit i palës referencë për debitorin (nëse është prezent në DS-02)
AT-07	Numri i llogarisë IBAN i debitorit
AT-13	Kodi BIC i OSHP-së së debitorit
AT-01	Referenca unike e mandatit
AT-25	Data e nënshkrimit të mandatit
AT-16	Hapësira për të dhënat e nënshkrimit elektronik
AT-06	Vlera e kërkesës për arkëtim
AT-11	Data e detyrimit të kërkesës për arkëtim
AT-24	Arsyeja për ndryshimin e mandatit (e detyrueshme nëse mandati ka ndryshuar)
AT-18	ID-ja e kreditorit të origjinës që ka lëshuar mandatin (përpara se mandati dhe kontrata përkatëse të merrej nga një kreditor tjetër)
AT-19	Referenca unike e mandatit e dhënë nga kreditori i origjinës që ka lëshuar mandatin (përpara se mandati dhe kontrata përkatëse të merrej nga një kreditor tjetër)
AT-22	Informacion i dhënë nga kreditori në kërkesën për arkëtim të debitimit direkt dhe dërguar debitorit për lehtësi të rakordimit të pagesave (jo i detyrueshëm)
AT-58	Qëllimi i kërkesës për arkëtim (jo i detyrueshëm)
AT-59	Kategoria e qëllimit të kërkesës për arkëtim (jo e detyrueshme)
AT-17	Tipi i mandatit (letër, elektronik)

DS-04: Kërkesë ndër-OSHP për arkëtim

OSHP-ja e kreditorit duhet të plotësojë kërkesën për arkëtim që do të dërgohet drejt OSHP-së së debitorit nëpërmjet sistemit AECH, me koleksionin e të dhënave të nevojshme, i cili përbëhet nga atributet e mëposhtme pjesë e listës së attributeve të paraqitura në Aneksin 1. Atributet janë të detyrueshme përveç nëse përcaktohet ndryshe.

<i>Kodi i atributit</i>	<i>Përshkrimi</i>
AT-20	Kodi identifikues i skemës DD në Shqipëri

AT-21	Tipi i transaksionit (1 - i vetëm, 2- përsëritës/rekurent jo i fundit i grupit, 3- i pari në një grup transaksionesh përsëritës/rekurent, 4- i fundit në një grup transaksionesh përsëritës/rekurent, 5- veprim me kah të kundërt)
AT-10	Referenca e kreditorit për transaksionin e debitimit direkt
AT-03	Emri i kreditorit
AT-38	Emri i palës referencë për kreditorin (nëse është prezent në DS-03)
AT-39	Kodi i identifikimit i palës referencë për kreditorin (nëse është prezent në DS-03)
AT-05	Adresa e kreditorit (nëse është prezent në DS-03)
AT-02	ID-ja e kreditorit
AT-04	Numri i llogarisë IBAN i kreditorit
AT-12	Kodi BIC i OSHP-së së kreditorit
AT-14	Emri i debitorit
AT-09	Adresa e debitorit (nëse është prezent në DS-03)
AT-27	Kodi i identifikimit të debitorit (nëse është prezent në DS-03)
AT-15	Emri i palës referencë për debitorin (nëse është prezent në DS-03)
AT-37	Kodi i identifikimit i palës referencë për debitorin (nëse është prezent në DS-03)
AT-07	Numri i llogarisë IBAN i debitorit
AT-13	Kodi BIC i OSHP-së së debitorit
AT-01	Referenca unike e mandatit
AT-25	Data e nënshkrimit të mandatit
AT-16	Hapësira për të dhënat e nënshkrimit elektronik (nëse është prezent në DS-03)
AT-06	Vlera e kërkesës për arkëtim
AT-11	Data e detyrimit të kërkesës për arkëtim
AT-26	Data e shlyerjes së kërkesës për arkëtim

AT-24	Arsyeja për ndryshimin e mandatit (nëse është prezent në DS-03)
AT-18	ID-ja e kreditorit të origjinës që ka lëshuar mandatin (nëse është prezent në DS-03)
AT-19	Referenca unike e mandatit e dhënë nga kreditori i origjinës që ka lëshuar mandatin (nëse është prezent në DS-03)
AT-22	Informacion i dhënë nga kreditori në kërkesën për arkëtim të debitimit direkt dhe dërguar debitorit për lehtësi të rakordimit të pagesave (nëse është prezent në DS-03)
AT-43	Referenca e OSHP-së së kreditorit për kërkesën për arkëtim
AT-58	Qëllimi i kërkesës për arkëtim (nëse është prezent në DS-03)
AT-59	Kategoria e qëllimit të kërkesës për arkëtim (nëse është e aplikueshme)
AT-17	Tipi i mandatit (letër, elektronik)

DS-05: Instruksionet e mospranimit, kthimit, rimbursimit të një kërkesë për arkëtim

Çdo instruksion për mospranim, kthim ose kërkesë për rimbursim, paraqitet si një koleksion të dhënash të nevojshme, i cili përbëhet nga atributet e mëposhtme pjesë e listës sëtributeve të paraqitura në Aneksin 1. Atributet janë të detyrueshme përveç nëse përcaktohet ndryshe.

<i>Kodi i atributit</i>	<i>Përshkrimi</i>
AT-R1	Tipi i mesazhit “R” (Reject, Return, Refund)
AT-R2	Identifikimi i tipit të palës që inicion mesazhin “R” (OSHP-ja e kreditorit (për Reject, Reverse), OSHP-ja e debitorit (për Reject, Return), operatori (vetëm Reject), kreditori (vetëm Reverse), debitori (vetëm Refund))
AT-R3	Kodi i arsyes për mospranim të kërkesës për arkëtim (Reject/Return/Refund)
AT-R4	Data e shlyerjes e kthimit ose rimbursimit
AT-R5	Referencë e posaçme e OSHP-së që inicion Reject/Return/Refund për atë Reject/Return/Refund

AT-R6	Kompensimi i rimbursimit që pranon OSHP-ja e debitorit nga OSHP-ja e kreditorit (jo i detyrueshëm – aplikohet vetëm për rimbursim)
AT-R8	Vlera e tarifës së shkëmbimit
	Një kopje të saktë të të gjithë atributëve në DS-04 që është marrë dhe që po kthehet/refuzohet/rimbursohet, ose të DS-07 që është marrë, përveç atributit AT-31 të DS-07 që po kthehet.

DS-06: Informacioni mbi debitimin direkt (OSHP-ja e debitorit - debitor)

Në rastet e ekzekutimit të një debitimi direkt dhe për rezultat debitimit të llogarisë së debitorit me OSHP-në e debitorit, OSHP-ja e debitorit i ofron debitorit informacion mbi veprimin e kryer. Ky informacion duhet të paraqitet si një koleksion të dhënash të nevojshme, i cili përbëhet nga atributet e mëposhtme pjesë e listës së atributëve të paraqitura në Aneksin 1. Atributet janë të detyrueshme përveç nëse përcaktohet ndryshe.

<i>Kodi i atributit</i>	<i>Përshkrimi</i>
AT-20	Kodi identifikues i skemës DD në Shqipëri
AT-03	Emri i kreditorit
AT-02	ID-ja e kreditorit
AT-01	Referenca unike e mandatit
AT-06	Vlera e kërkesës për arkëtim
AT-22	Informacion i dhënë nga kreditori në kërkesën për arkëtim të debitimit direkt dhe dërguar debitorit për lehtësi të rakordimit të pagesave
AT-10	Referenca e kreditorit për transaksionin e debitimit direkt

DS-07: Veprimi me kah të kundërt i kërkesës për arkëtim (ndër-OSHP)

Në rast të një instruksioni të iniciuar nga kreditori si veprim me kah të kundërt i një kërkesë për arkëtim të shlyer si debitim direkt, OSHP-ja e kreditorit duhet të përcjellë këtë instruksion në sistemin AECH, duke përfshirë të gjithë informacionin e nevojshëm të paraqitur si një koleksion të dhënash, i cili përbëhet nga atributet e mëposhtme pjesë e listës së atributëve të paraqitura në Aneksin 1. Atributet janë të detyrueshme përveç nëse përcaktohet ndryshe.

<i>Kodi i atributit</i>	<i>Përshkrimi</i>
AT-04	Numri i llogarisë IBAN i kreditorit
AT-12	Kodi BIC i OSHP-së së kreditorit
AT-R2	Identifikimi i tipit të palës që inicion mesazhin “R”

AT-R4	Data e shlyerjes e veprimit me kah të kundërt
AT-44	Vlera e veprimit me kah të kundërt të kërkesës për arkëtim
AT-31	Kodi i arsyes së kthimit me kah të kundërt të kërkesës për arkëtim (dublikim, arsye e paspecifikuar)
AT-43	Referenca e OSHP-së së kreditorit për kërkesën për arkëtim
AT-R7	Referencë e posaçme e OSHP-së së kreditorit për veprimin me kah të kundërt
	Një kopje të saktë të të gjitha attributeve në DS-04 që është marrë dhe që po kthehet me kah të kundërt

DS-08: Kërkesë dhe përgjigje për pretendim për rimbursim transaksioni të paautorizuar

Në raste të pretendimeve të ngritura nga debitori për rimbursim transaksioni të paautorizuar, e të cilat pranohen nga OSHP-ja e debitorit, këto pretendime duhet të përcillen nga OSHP-ja e debitorit për tek OSHP-ja e kreditorit, i cili në vijim duhet ta përcjellë tek kreditori në trajtën e një koleksioni të dhënash që përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, i cili përbëhet nga atributet e mëposhtme pjesë e listës së attributeve të paraqitura në Aneksin 1. Atributet janë të detyrueshme përveç nëse përcaktohet ndryshe.

Koleksioni i të dhënave përmban informacion:

1. për dërgimin e kërkesës për rimbursim të një transaksioni të paautorizuar nga OSHP-ja e debitorit tek OSHP-ja e kreditorit, e më pas për t'u përcjellë nga OSHP-ja e kreditorit tek kreditori;
2. për dërgimin e përgjigjes mbi kërkesën për rimbursim nga OSHP-ja e kreditorit tek OSHP-ja e debitorit.

<i>Kodi i atributit</i>	<i>Përshkrimi</i>
	<i>Procedura e kërkesës</i>
AT-45	Referenca e OSHP-së së debitorit për kërkesën
AT-46	Kodi i tipit të kërkesës për rimbursim
AT-47	Data e marrjes së kërkesës nga OSHP-ja e debitorit
AT-48	Data e dërgimit të kërkesës nga OSHP-ja e debitorit
AT-49	Emri i OSHP-së së debitorit
AT-50	Detajet e kontaktit të OSHP-së së debitorit
AT-51	Adresa email ose numri i faksit të OSHP-së së debitorit ku kopja e mandatit duhet të dërgohet nga OSHP-ja e kreditorit.
AT-12	Kodi BIC i OSHP-së së kreditorit (Jo i detyrueshëm)

AT-04	Numri i llogarisë IBAN i kreditorit (Jo i detyrueshëm)
At-52	Treguesi nëse kërkohet konfirmim i marrjes së kërkesës nga OSHP-ja e kreditorit (po/jo)
	<i>Mbi kërkesën për arkëtim të kontestuar</i>
AT-20	Kodi identifikues i skemës DD në Shqipëri
AT-02	ID-ja e kreditorit
AT-03	Emri i kreditorit
AT-10	Referenca e kreditorit për transaksionin e debitimit direkt
AT-43	Referenca e OSHP-së së kreditorit për kërkesën për arkëtim
AT-01	Referenca unike e mandatit
AT-06	Vlera e kërkesës për arkëtim
AT-13	Kodi BIC i OSHP-së së debitorit
AT-07	Numri i llogarisë IBAN i debitorit
AT-14	Emri i debitorit
AT-53	Data e debitimit të kërkesës për arkëtim (nëse është e ndryshme nga data e shlyerjes)
AT-26	Data e shlyerjes së kërkesës për arkëtim
AT-54	Data më e fundit e kërkesës për arkëtim (ky atribut ose AT-55)
AT-55	Data e anulimit (aplikohet për Rimbursim tipi 3) (ky atribut ose AT-54)
AT-17	Tipi i mandatit (letër, elektronik)
	<i>Për përgjigjen nga OSHP-ja e kreditorit tek OSHP-ja e debitorit</i>
AT-56	Referenca e përgjigjes së kreditorit (mbi kërkesën e OSHP-së së debitorit) (jo e detyrueshme)
AT-57	Kodet e tipeve të përgjigjes (vlerat 1 dhe 2, 2 dhe 3 mund të aplikohen së bashku në një përgjigje)

DS-10: Kërkesë për të marrë një kopje të mandatit

OSHP-ja e debitorit mund të kërkojë ,sipas rastit e për qëllim verifikimi, kopje të mandatit të kërkesës për arkëtim. Kërkesa për kopje të mandatit hartohet si një koleksion të dhënash që përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, i cili përbëhet nga atributet e mëposhtme pjesë e listës së attributeve të paraqitura në Aneksin 1. Atributet janë të detyrueshme përveç nëse përcaktohet ndryshe.

Koleksioni i të dhënave përmban informacion:

1. për dërgimin e kërkesës për të marrë një kopje të mandatit nga OSHP-ja e debitorit tek OSHP-ja e kreditorit, e më pas për t'u përcjellë nga OSHP-ja e kreditorit tek kreditori;
2. për dërgimin e përgjigjes mbi kërkesën për të marrë një kopje të mandatit nga OSHP-ja e kreditorit tek OSHP-ja e debitorit.

<i>Kodi i atributit</i>	<i>Përshkrimi</i>
	<i>Procedura e kërkesës</i>
AT-45	Referenca e OSHP-së së debitorit për kërkesën
AT-48	Data e dërgimit të kërkesës nga OSHP-ja e debitorit
AT-49	Emri i OSHP-së së debitorit
AT-50	Detajet e kontaktit të OSHP-së së debitorit
AT-51	Adresa email ose numri i faksit të OSHP-së së debitorit ku kopja e mandatit duhet të dërgohet nga OSHP-ja e kreditorit
AT-12	Kodi BIC i OSHP-së së kreditorit (jo i detyrueshëm)
AT-20	Kodi identifikues i skemës DD në Shqipëri
AT-02	ID-ja e kreditorit
AT-03	Emri i kreditorit
AT-01	Referenca unike e mandatit
AT-14	Emri i debitorit
AT-17	Tipi i mandatit (letër, elektronik)
	<i>Për përgjigjen nga OSHP-ja e kreditorit tek OSHP-ja e debitorit</i>
AT-56	Referenca e përgjigjes së kreditorit (mbi kërkesën e OSHP-së së debitorit) (jo e detyrueshme)
AT-57	Kodet e tipeve të përgjigjes

Aneks 3 – Termat kohorë për përmbushjen e veprimeve

<i>Kategoria</i>	<i>Parametri</i>	<i>Afati kohor</i>	<i>Data referencë</i>
Kërkesat për arkëtim	njoftimi paraprak	14 ditë kalendarike	data e detyrimit
	dërgimi i kërkesës për arkëtim	14 ditë kalendarike	data e detyrimit
	dërgimi i kërkesës për arkëtim në AECH	1 ditë pune ndërbankare	data e detyrimit
Kthimet	shlyerja e kthimeve	5 ditë pune ndërbankare	data e detyrimit
Rimbursimi	afati për rimbursim pa arsyetim	8 javë	data e debitimit
	afati për kompensimin për rimbursim	8 javë + 2 ditë pune ndërbankare	data e debitimit
Rimbursimi i veprimit të paautorizuar	afati për rimbursim veprimi të paautorizuar	afati i përcaktuar në nenin 1022 të Kodit Civil	data e debitimit
	përcjellja e pretendimit për rimbursim tek OSHP-ja e kreditorit	4 ditë pune	data e marrjes së kërkesës nga OSHP-ja e debitorit
	përcjellja e pretendimit për rimbursim tek kreditori	3 ditë pune	data e marrjes së kërkesës nga OSHP-ja e kreditorit
	përgjigja e kreditorit për pretendimin për rimbursim	7 ditë pune	data e marrjes së kërkesës nga kreditori
	afati për pritjen e përgjigjes	30 ditë kalendarike	data e marrjes së pretendimit nga OSHP-ja e debitorit
	afati për vendimin për rimbursim	4 ditë pune ndërbankare	data e marrjes së

			përgjigjes nga OSHP-ja e debitorit prej OSHP-së së kreditorit
Veprimi me kah të kundërt	pagesa për veprim me kah të kundërt	5 ditë pune ndërbankare	data e shlyerjes
Mandati	periudha e inaktivitetit	36 muaj	data e fundit e përdorimit
Kërkesa për kopje mandati	përcjellje e kërkesës për kopje mandati	3 ditë pune	data e marrjes së kërkesës nga OSHP-ja e kreditorit
	përcjellje kopje mandati	7 ditë pune	data e marrjes së kërkesës nga kreditori

Aneks 4 – Model mandati

MANDATI

Kreditori: LOGO, Emri i kompanisë

Identifikuesi i kreditorit: XXnnnnnnnnnn (gjenerohet nga Banka e Shqipërisë)

Adresa e kreditorit: _____

Referenca e mandatit: _____ (gjenerohet nga kreditori)

(Teksti ligjor që përmban emrat e palëve që nënshkruajnë mandatin)

Duke nënshkruar këtë mandat, ju autorizoni (A) kreditorin për të dërguar udhëzime në OSHP-në tuaj për të debituar llogarinë tuaj dhe (B) OSHP-në tuaj për të debituar llogarinë tuaj, në përputhje me udhëzimet e marra nga kreditori.

Si pjesë e të drejtave tuaja, ju keni të drejtën për rimbursim nga OSHP-ja juaj, në përputhje me kushtet e parashikuara në kontratën mes jush dhe OSHP-së suaj. Rimbursimi mund të kërkohe brenda 8 javëve *(afati sipas përcaktimeve në Aneksin 3 të rregullores “Për debitimin direkt”)*, duke filluar nga data në të cilën llogaria juaj është debituar.

Të drejtat tuaja shpjegohen në një deklaratë/dokument të cilin ju mund ta merrni në OSHP-në tuaj.

Emri i debitorit: _____

Adresa e debitorit: _____

Kodi postar, qyteti, shteti i rezidencës: _____

BIC (i debitorit): _____

Numri i llogarisë së debitorit (IBAN): _____

Tipi i pagesës: (1 - e vetme, 2- përsëritëse/rekurente) _____

Numri identifikues i kontratës (jo i detyrueshëm): _____

Data, vendi i nënshkrimit: _____

Nënshkrimi i debitorit: _____